

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Evropiane dhe të Sigurisë – 32

ÇËSHITJE EVROPIANE DHE TË SIGURISË

Security Issues

Revistë tremujore për sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 32, korrik 2016

Bordi Shkencor:

Dr. Pëllumb Qazimi (anëtar)

Dr. Elona Dhëmbo (anëtar)

MA Arjan Dymishi (anëtar)

MA Gjergji Vurmo (anëtar)

Ky numër u përgatit nga:

Mirsada Hallunaj – MA

Besjana Kuçi – M.Sc

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të

Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s.

PËRMBAJTJA

Parathënie	6
-------------------	----------

András BRAUN

Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor: Një aspekt i mundshëm për stabilitet dhe anëtarësim?	8
---	----------

Daniel TRENCHOV

Nga kërcënimi humanitar në atë të sigurisë: Mit apo Realitet?	35
--	-----------

Eranda BEGAJ

Një vështrim mbi fushën e sigurisë kibernetike në Shqipëri	59
---	-----------

Miranda BOSHNJAKU

Migracioni në vite dhe procesi i riintegrit	76
--	-----------

Wojciech LORENZ, Mário NICOLINI

Zgjerimi i NATO-s: Çfarë do të sjellë Samiti i Varshavës?	100
--	------------

English Abstracts	120
--------------------------	------------

PARATHËNIE

Revista për Çështjet Evropiane dhe të Sigurisë është një botim që synon të kontribuojë në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave, mbi reformat dhe performancën e sektorit të sigurisë, prirjet evropiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet e debatueshme dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

Nëpërmjet studimeve të realizuara nga ekspertë të fushave si dhe kontributit të studiuesve të ndryshëm, Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, sjell në vëmendje studimet në numrin e ri të kësaj reviste, analiza e rekomandime të kryera së fundmi përgjatë vitit 2016 të përqendruar në disa tematika kryesore:

- Migracioni, kriza e refugjatëve dhe radikalizmi;
- Kthimi i azil kërkuesve dhe çështje që lidhen me riintegrimin;
- Qeverisja e mirë dhe institucionet demokratike;
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve shtetërore.

Një vëmendja e veçantë në këtë numër të Revistës i është kushtuar Samitit të NATO-s, që u zhvillua në Varshavë gjatë datave 8-9 Korrik

2016, në të cilin morën pjesë 60 kryetarë shtetesh dhe kryetarë qeverish të vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s. Samiti u konsiderua një ngjarje mjaft e rëndësishme, pasi u zhvillua në një moment kur sfidat e sigurisë dhe situata gjeopolitike janë mjaft serioze dhe delikate. Në këtë kontekst ky numër e trajton këtë ngjarje lidhur me kontekstin e zhvillimeve rajonale në Ballkan, por edhe më gjerë, duke u fokusuar gjithashtu në strategjitë mbi sigurinë, mbrojtjen kolektive, menaxhimin e situatave të krizës etj.

BASHKËPUNIMI RAJONAL NË BALLKANIN PERËNDIMOR

NJË ASPEKT I MUNDSHËM PËR STABILITET DHE ANËTARËSIM?

András BRAUN¹

1. Bashkëpunimi rajonal: një aspekt i mundshëm për stabilitet dhe anëtarësim

Vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM), Mali i Zi, Kosova dhe Serbia janë angazhuar për anëtarësim në BE dhe NATO. Në këtë mënyrë, në fund të viteve 1990 rajonalizimi u bë një faktor i rëndësishëm ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, në veçanti një parakusht për anëtarësim në BE. Roli i bashkëpunimit rajonal ishte të krijonte stabilitet dhe ti jepte këtyre vendeve perspektivën e prosperitetit. Rivendosja e stabilitetit dhe sigurisë ishte qëllimi i parë i këtij lloji të ri të marrëdhënieve ndërmjet BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor.

¹ András Braun (1990): Studiuese e Shkencave Politike, aktualisht studente në PhD, Universiteti Eotvos Lorand, Budapest, Hungari.

Megjithatë, Bashkimi Evropian donte të nxiste gjithashtu zbatimin e marrëveshjeve të paqes dhe të ndihmonte stabilitetin politik dhe ekonomik, duke përfshirë demokracinë dhe sundimin e ligjit. Kushtet dhe para-kushtet e anëtarësimit në BE-së përcaktuan në mënyrë të qartë se këto vende duhet të krijojnë bashkëpunim rajonal dhe organizata rajonale në rajonin e Evropës Juglindore.

Për të analizuar procesin e integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, është e rëndësishme të studjohen objektivat e bashkëpunimit rajonal. Anëtarësimi i republikave të ish-Jugosllavisë në Bashkimin Evropian (me përjashtim të Sllovenisë dhe Kroacisë) mbetet ende një çështje e hapur. Megjithatë, dy dekadat e fundit kanë treguar një progres të procesit në rajon. Rajonalizimi mund të jetë një mjet për të stabilizuar jo vetëm sigurinë, por edhe politikën dhe ekonominë e këtyre vendeve. Kjo është arsyeja pse Bashkimi Evropian insiston për të krijuar lloje të reja të bashkëpunimit në rajon.

E ardhmja e rajonit të Ballkanit Perëndimor nuk është e mundur të parashikohet me siguri, por njëzet vitet e fundit na kanë treguar se ka një shpresë inkurajuese për të ardhmen.

Qëllimi i këtij artikulli është të japë një pasqyrë të marrëveshjeve rajonale, në të cilat shtetet e Ballkanit Perëndimor janë integruar tashmë në perspektivën e anëtarësimeve në BE dhe NATO. Përveç

fakteve pozitive, dëshiroj të vë në dukje rrethanat penguese, të cilat sfidojnë vendet.

1.1. Ballkani Perëndimor

Termi “Ballkani Perëndimor” u krijua nga Bashkimi Evropian, pas Samitit të Selanikut në vitin 2003. Përkushtimi i BE-së për të mbështetur vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt integritit evropian, çoi në miratimin e “Deklaratës së Selanikut, si edhe të ashtuquajturës Axhenda e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: drejt Integritit Evropian”. (Marrëdhëniet e BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor)

Kjo lloj qasjeje rezultoi në një kuadër të ri politikash: Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA), Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS) dhe Politika e Përbashkët për Mbrojtje dhe Siguri (PPMS). Procesi politik i zgjerimit përfshin gjithashtu një ndihmë të rëndësishme financiare, Instrumentin për Asistencën të Para-Anëtarësimit (IPA). Në kuadër të procesit të Stabilizim Asociimit, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore janë thelbësore për stabilitetin dhe procesin e bashkërendimit të vazhdueshëm të rajonit. (Marrëdhëniet e BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor)

Më vonë në vitin 2006, Këshilli Evropian rikonfirmoi “nevojën për kushte të drejta dhe rigorozë në përputhje me kriteret politike të

Kopenhagenit, PSA-në dhe konsensusin e arritur për aderimin e vendeve të reja në BE” (Zgjerimi i BE-së)

Në procesin e anëtarësimit, roli i Komisionit është shumë i rëndësishëm. Çdo vjeshtë, Komisioni Evropian miraton progres raporte individuale të vendeve kandidate dhe atyre potenciale.

1.2. Pyetja e parë: Si të arrihet Stabiliteti?

Pas luftërave në Jugosllavi dhe Kosovë, NATO filloi të luajë një rol të rëndësishëm në aspektin e sigurisë në rajon. Përveç misioneve paqeruajtëse, Bashkësia Ndërkombëtare kërkonte të vendoste stabilitet ndërmjet vendeve. Në këtë mënyrë u bë e nevojshme të gjehej një qasje të re në drejtim të stabilitetit të vendeve të Ballkanit. Jo vetëm stabiliteti, por edhe anëtarësimi u bë një perspektivë e rëndësishme në fund të viteve 1990 për vendet e Ish-Jugosllavisë dhe Shqipërinë. Këto janë vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia.²

Pas shpalljes së kërkesave nga ana e Bashkësisë Ndërkombëtare, duhet të shtrohet një pyetje shumë e rëndësishme: “Si mund të arrihet

² Dy republika ish-Jugosllave, Sllovenia dhe Kroacia i janë bashkuar tashmë Bashkimit Evropian. Nga kjo pikëpamje këto dy vende nuk janë pjesë e Ballkanit Perëndimor.

stabiliteti në rajon pas konfliktit?” Në këtë mënyrë mund të shkojmë tek pyetja e dytë e rëndësishme: “Çfarë është stabiliteti?”

Përgjigja më e thjeshtë është se stabiliteti është i përbërë nga tre elementë kryesorë:

- 1) Politika
- 2) Ekonomia
- 3) Politika e Sigurisë

Është e qartë se Bashkimi Evropian dhe NATO mund të përcaktojnë këto komponentë të nxjerrë në pah. Por, siç do të shihet më vonë, këto elemente janë edhe sfidat më të mëdha për vetë vendet.

Pas luftës së Kosovës ishte e qartë se misionet paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO-ja nuk ishin në gjendje të kryenin të vetme procesin e plotë të stabilizimit. Për këtë arsye BE-ja paraqitet si një lojtar kyç në rajon prej vitit 1999. Në këtë mënyrë, bashkëpunimi rajonal është bërë një faktor i rëndësishëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i parë i bashkëpunimit rajonal ishte të rivendoste stabilitetin dhe sigurinë dhe të jepte një perspektivë të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

1.3. Pyetja e dytë: Anëtarësimi (Euro Atlantik)

Pavarësisht gjithë këtyre, në drejtim të stabilitetit dhe anëtarësimit mund të jetë shumë e vështirë për të dalluar rolin e BE-së dhe NATO-s.

Është e qartë, se pas dy luftërave, ndërhyrjet ushtarake dhe operacionet paqeruajtëse ishin të pashmangshme.

Por, prej një periudhe më shumë se 20 vjet pas konfliktit të armatosur, mund të pretendohet se rajoni ka bërë përparime të mëdha. Kjo do të thotë se pas vendosjes së stabilitetit, për këto vende është ofruar perspektiva e anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Për më tepër, për arsye të ndryshme këto dy aktorë kanë gjithashtu interesat e tyre për të integruar Ballkanin Perëndimor.

Siç është përshkruar më herët, stabiliteti dhe anëtarësimi janë procese të pandashme: pas përgjigjes së pyetjeve në lidhje me politikën e sigurisë, është e qartë se mund të trajtohen çështjet politike dhe ekonomike, të tilla si rivendosja e rendit politik dhe kushtetues të shteteve në rajon; ose menaxhimi i tranzicionit në ekonominë e tregut.

Nga njëra anë vende si Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia përjetuan luftën, ndërsa nga ana tjetër Shqipëria kaloi një sistem totalitar. Të dyja përvojat po i tërheqin prapa këto vende, duke shkaktuar shumë kriza dhe vështirësi në proceset e tranzicionit.³

Kjo mund të jetë arsyeja kryesore (ndërmjet shumë të tjerave), pse anëtarësimi është një proces në vazhdim.

³ Studimi nuk do të shtjellojë në detaje procesin e tranzicionit të vendeve.

Për të arritur stabilitetin dhe anëtarësimin, BE-ja prezantoi PSA-në në vitin 1999. PSA mundëson vendet e Ballkanit Perëndimor të krijojnë forma të ndryshme të reja të bashkëpunimit në rajon, të cilat janë në gjendje të japin një zgjidhje të duhur për sfidat, të cilat ndikojnë në këto vende. Përveç kësaj, NATO mbetet një lojtar i rëndësishëm në aspektin e sigurisë.

2. Kushtet e Stabilitetit

Bashkëpunimi rajonal mund të jetë një lloj i ri i strategjisë së paqes në rajon. Por këto lloje bashkëpunimi nuk janë të vetmet kritere politike të Integritimit Evropian. Lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve mund të lidhë vendet përtej kufijve dhe gjithashtu mundëson ndarjen e burimeve. Gjithashtu, këto marrëveshje mund të motivojnë qeveritë për të përmbushur çdo lloj reforme politike dhe ekonomike të kërkuara nga BE.

Pas krizës së Kosovës, BE-ja ka vendosur të riorganizojë marrëdhëniet e saj me rajonin. Në këtë mënyrë BE-ja ka vendosur një objektiv të dyfishtë:

Së pari, të përmirësojë sigurinë, çështjet politike dhe ekonomike, për të lehtësuar stabilizimin e rajonit.

Së dyti, të sigurojë mundësinë për Integrimin Evropian.

Nga kjo pikëpamje është e qartë se bashkëpunimi rajonal duket si një instrument paqeruajtës. Këto marrëveshje kishin për qëllim të krijonin një kornizë të zgjidhjes së problemeve ndërmjet vendeve të rajonit. Ky sistem kornizë është përgjegjës për miratimin e Marrëveshjes së Dejtonit për paqe, si dhe për stabilizimin politik dhe ekonomik të rajonit. Marrëveshjet rajonale janë në gjendje të ndihmojnë në përparimet në pyetje që lidhen me demokracinë dhe shtetin e së drejtës, por edhe mirëqenien ekonomike.

BE e ka bërë të qartë, se marrëveshjet rajonale janë pjesë e domosdoshme e kriterëve të anëtarësimit.

Edhe pas një periudhe të suksesshme të reformave, disa kriza politike po zhvilloheshin në Ballkanin Perëndimor.

Mund të renditen shembujt e mëposhtëm:

- 1) Kriza qeveritare dhe politike në Maqedoni;
- 2) Konfrontimi etnik në Maqedoni;
- 3) Problemet në marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës;⁴
- 4) Kriza politike në Mal të Zi.

Këto janë debatet më të fundit dhe komplekse politike, të cilat po shqetësojnë thellësisht Brukselin. Nuk mund të theksohet mjaftueshëm se siguria është e shtrirë në stabilitetin politik të rajonit.

⁴ Madje edhe ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë, gjatë negociatave të kapitujve të aderimit në BE.

Dhe në disa situata të rëndësishme, madje edhe çështjet që lidhen me procesin e anëtarësimit në BE apo NATO, mund të shkaktojnë mosmarrëveshje serioze në ose midis vendeve. Nuk duhet harruar, çfarë ndodhi pas një marrëveshje të suksesshme të pushtetit, menaxhuar nga BE-ja.⁵ Një krizë e rëndë politike filloi në Kosovë, duke shkaktuar jo vetëm paqartësi në politikën e brendshme, por edhe duke ndikuar në çështjet e pakicave në rajonin e Mitrovicës. (Vasović és Pawlak 2013)

Një tjetër debat serioz dhe shqetësues politik ka filluar në Mal të Zi. Në një mënyrë shumë të thjeshtë, origjina e problemit mund të trajtohet në dy mënyra. Së pari, ka një pakënaqësi masive me qeverinë dhe partinë në pushtet. E dyta është një çështje e ndjeshme dhe emocionale, duke qenë se Mali i Zi ka lidhje shumë të ngushtë identike me Serbinë, disa malazezë refuzojnë pranimin në NATO të vendit të tyre.

Këta shembuj thjesht demonstrojnë procesin e vazhdueshëm të transformimit në rajon.

2.1. Fillimi i krijimit të marrëveshjeve rajonale

Faza e parë e zhvillimit të marrëveshjeve rajonale mund të vendoset ndërmjet viteve 1996 dhe 1999. Nga kjo periudhë është me vlerë të përmendet Procesi Royaumont dhe Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), të cilat u iniciuan nga vendet e Ballkanit

⁵ E ashtuquajtura Marrëveshje e Brukselit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës (ose Marrëveshja Beograd dhe Prishtinë)

Perëndimor. Një iniciativë tjetër e rëndësishme ishte krijimi i Qasjes Rajonale në vitin 1996, bazuar në marrëdhëniet dypalëshe. (Kemenszky, 2-3).

Procesi Royaumont është përqendruar në stabilizimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë; qëllimi i SEECP ishte të sigurate një zë të përbashkët për Evropën Juglindore. Në këtë kohë BE-ja ofroi ndihmë për marrëveshjet dhe bashkëpunimin rajonal. Kjo do të thotë se bashkëpunimi i parë është shfaqur në fazën e hershme, e cila ka vendosur rrugën për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. (Deleviç 2007, 17-19)

2.2. Drejt Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit

Në historinë e marrëdhënieve rajonale viti 1999 paraqet një pikë kthese. Në qershor të vitit 1999 u prezantua Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, me qëllim për të siguruar një zgjidhje afatgjatë për adresimin e sfidave të sigurisë në Evropën Juglindore. (Deleviç 2007, 17-19) Në vitin 2008 ai u zëvendësua nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, duke synuar promovimin e stabilitetit brenda rajonit. Ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve të SECCP po marrin pjesë në proces dhe Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kroacia kanë arritur statusin e vendit kandidat në kuadër të organizatës. (Lőrinczné Bencze 2015 259).

Pakti i Stabilitetit ka qenë një hap i rëndësishëm në rrugën e procesit të Stabilizim-Asociimit, për shkak se ka vendosur lidhjen mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor brenda një kornize të re. (Kemenszky, 4)

Qëllimi i Bashkimit Evropian me Paktin e Stabilitetit ishte të krijonte një kuadër të vet bashkëpunimi me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në vitin 1999 Komisioni Evropian shpalli Procesin e Stabilizim-Asociimit (PSA) për rajonin. PSA mund të konsiderohet si instrumenti kryesor i Bashkimit Evropian për të përmbushur Agjendën e Selanikut. Prandaj, PSA synon të rrisë sigurinë dhe zhvillimin e rajonit dhe të advokojë vendosjen e bashkëpunimit rajonal. PSA lejon vendet brenda rajonit të arrijnë një pozitë strategjike të marrëdhënies me BE-në dhe synon të krijojë kushtet e anëtarësimit në BE.

Përveç Paktit të Stabilitetit, Bashkimi Evropian kërkoi të nisë një proces të dytë stabilizimi. Qëllimi i vendimmarrësve evropianë ishte të krijonin një organizatë, e cila është e aftë të promovojë jo vetëm konvergjencën e vendeve brenda rajonit në mënyrë më efikase, por edhe përpjekjet e tyre të pranimit. Kjo është arsyeja pse në vitin 1999 u krijua Procesi i Stabilizim-Asociimit. (Deleviç 2007, 23)

Qëllimi i PSA nuk është vetëm të stabilizojë, por edhe të ofrojë perspektivën e anëtarësimit të mundshëm në të ardhmen. PSA jep hapësirë për qëllimet e përbashkëta politike, ekonomike. Të gjitha këto rezultate dhe përparime vlerësohen çdo vit nga BE-ja (ose më saktë nga

Komisioni Evropian). Këto marrëveshje janë krijuar në mënyrë bilaterale. BE-ja ka zbatuar një qasje të konsoliduar, qëllimi i së cilës është të lehtësojë procesin e stabilizimit, dhe më pas të lejojnë edhe anëtarësimin. (Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit 2012)

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) ka për qëllim të lehtësojë marrëdhëniet ndërmjet shteteve. (Kemenszky, 4) MSA-ja është kuadri në të cilin po zhvillohet komunikimi mes BE-së dhe vendeve të BP6. Ky proces ndihmon për të zbatuar kriteret e përcaktuara në PSA. (Marrëveshja e Stabilizim Asociimit 2012)

PSA lejon mundësinë që në mënyrë sistematike të zhvillohen dhe të përcaktohen kushtet e nevojshme dhe parakushtet në lidhje me pranimin. Këto kushte dhe parakushte janë duke u fokusuar në 4 fusha: marrëdhëniet kontraktuale, marrëdhëniet tregtare, të ndihmës financiare dhe në fund bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore. (Procesi i Stabilizim Asociimit - PAS 2014)

Në detaje:

1) Sistemet aktuale të mbështetjes ekonomike dhe financiare duhet të zhvillohen më tej, e cila natyrisht nuk përjashton mundësinë e marrëdhënieve të reja ekonomike dhe tregtare;

2) Cilësia e demokracisë duhet të përmirësohet dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të mbështeten;

3) Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet fushave të drejtësisë dhe punëve të brendshme për shkak të aspekteve të sigurisë;

4) Zhvillimi i dialogut politik duhet të forcohet, duke lehtësuar komunikimin ndërmjet vendeve (Delevic 2007 25-29).

Është gjithashtu e rëndësishme, që përveç vendosjes së qëllimeve të PSA, Bashkimi Evropian të bëntë gjithashtu disa premtime. Këto janë të përshkruara në tri pika të ndryshme: ekonomike, tregtare, dhe anëtarësimit të plotë në BE. Këto premtime janë të integruara në kuadër të MSA-së të vendosur nga BE-ja. (Deleviç, Bashkëpunim rajonal në Ballkanin Perëndimor 2007, 25)

Në përfundim mund të thuhet, se elementet më të rëndësishme të PSA përcaktojnë në thelb marrëdhëniet ndërmjet 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian. Këto marrëdhënie kontraktuale janë krijuar në mënyrë bilaterale dhe janë në harmoni me MSA-në. Një rol i mëtijshëm i PSA është të nxisë krijimin e llojeve të reja të integritetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. (Deleviç 2007, 25-29)

Vendet kandidatë kanë marrë një sasi të konsiderueshme të fondeve nga BE-ja. Financimi dhe mbështetja e BE-së po ndodh nga Instrumenti i Ndhmës së Para-Anëtarësimit (IPA), e cila përbëhet nga pesë komponentë të rëndësishëm:

1. Asistenca e Tranzicionit dhe Ngritja e Institucioneve;
2. Bashkëpunimi Ndërkufitar;

3. Zhvillimi Rajonal;
4. Zhvillimi i Burimeve Njerëzore;
5. Zhvillimi Rural. (Komisioni Evropian - Zgjerimi - IPA 2012)

Për periudhën 2014-2020 IPA II, do të ketë një buxhet 11.7 miliardë €. Vendet përfituese janë gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. (Përmbledhje - Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit 2016).

2.3. Arsyja e krijimit të PSA

Përvojat e procesit të zgjerimit në lindje të Bashkimit Evropian treguan se Brukseli inkurajoi më fillimisht shtetet e reja anëtare të krijojnë bashkëpunim rajonal para anëtarësimit. Një shembull i mirë mund të jetë V4 (Vendet e Vishegradit)⁶ dhe gjithashtu CEFTA, në të cilën vendet e BP6 janë integruar tashmë, edhe pse vendet e BP6 synohet të kenë një bashkëpunim më të thellë ndërmjet tyre. (Börzel és Risse 2009 18)

Në përfundim mund të thuhet se qëllimi kryesor i PSA është të ndihmojë koordinimin dhe të lehtësojë procesin e integritetit për shtetet kandidate. Prandaj Ballkani Perëndimor është bërë anëtar i një partneriteti progresiv, në të cilin duket një potencial i veçantë për të krijuar marrëveshjet rajonale dhe gjithashtu zonat e tregtisë së lirë. MSA-ja është një pajisje bilaterale dhe kjo është arsyeja pse ajo

⁶ Polonia, Hungaria, Çekia, Sllovakia

përforcon rivalitetin ndërmjet vendeve dhe nuk forcon në mënyrë të suksesshme bashkëpunimin në të gjitha fushat. (Kemenszky, 4)

Pikërisht për këtë arsye MSA-ja nuk ishte në gjendje të hyjë në fuqi në të njëjtën kohë midis vendeve kandidate. Vendi i parë i Ballkanit Perëndimor në të cilin Marrëveshja ka hyrë në fuqi ishte Maqedonia në vitin 2004. Më pas procesi i integritimit në IRJM u ngadalësua dhe sot vendi po përjeton një krizë të rëndë politike. Më tej, MSA hyri në fuqi në Shqipëri (2009), Bosnjë dhe Hercegovinë (2015), Mal të Zi (2010), Serbi (2013) dhe më në fund Kosovë (2016). (Braun 2015 12-13)

1. Statusi i vendit kandidat në BE dhe hyrja në fuqi e PSA në vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendi	Statusi i Vedit Kandidat në BE	PSA në fuqi
Shqipëria	Kandidat	2009
Bosnje - Hercegovina	Kandidat Potencial	2015
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Kandidat	2004
Mali i Zi	Kandidat, Ka filluar Procesi i Negociatave	2010
Kosova	Kandidat Potencial	2016
Serbia	Kandidat, Ka filluar Procesi i Negociatave	2013

2.3.1. Procesi i Berlinit: Një lloj i ri i bashkëpunimit rajonal?

Për shkak të sfidave të viteve të fundit, Bashkimi Evropian inicioi të ashtuquajturin Proces të Berlinit. Ky proces u iniciua nga Gjermania, Austria, Franca dhe ato vende për anëtarësim në BE, të cilat janë të angazhuara për zgjerimin e mëtejshëm të Bashkimit Evropian.

Kjo do të thotë se vendet në fjalë takohen çdo vit për të diskutuar çështjet e pranimit. Gjatë këtyre diskutimeve janë prekur temat e marrëdhënieve, marrëveshjeve rajonale, krizës së refugjatëve, të rinjve etj. (Komisioni Evropian 2015)

3. Ballkani Perëndimor dhe NATO

Në lidhje me llojet e ndryshme të integritit në BE dhe kushteve për anëtarësim, është e pamohueshme që kjo paraqet sfida për vendet e BP6. Por këto janë kushtet politike (dhe në disa raste ekonomike). Pavarësisht nga dëshira e integritit, procesi kompleks i anëtarësimit në BE mund të shkaktojë ndryshime në disa situata ndërmjet shteteve kandidate. Kjo është një nga arsyt kryesore⁷, pse gjashtë vendet kandidate nuk janë ende në të njëjtin nivel.

Është e qartë se në çështjet e pranimit në BE, mund të shihen disa dallime ndërmjet niveleve të anëtarësimit ndërmjet vendeve.

⁷ Ndërmjet shumë arsyeve të tjera të rëndësishme

Prandaj pritet që Bashkimi Evropian nuk do të jetë në gjendje për të integruar të gjithë rajonin në të njëjtën kohë. Aktualisht dy vende kanë filluar procesin e negociatave: Mali i Zi dhe Serbia.

Dy vende, Shqipëria dhe Maqedonia janë ende në pritje për të filluar negociatat. Së fundi, ka dy vende kandidate potenciale, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova, të cilave i është premtuar mundësia e bashkimit në negociata, kur ato të jenë të gatshme. (Kontrollo statusin aktual 2016)

Përveç kompleksitetit të pranimin në BE dhe debateve politike, stabiliteti dhe paqja mbetet një pyetje themelore në rajon. Duke u kthyer në objektivin thelbësor të viteve 1990, stabiliteti mund të arrihet me integrimin Euro Atlantik. Prandaj është e nevojshme të analizohen marrëdhëniet e vendeve të BP6 jo vetëm me BE-në, por edhe me NATO-n.

3.1. Zgjerimi i NATO-s në Ballkan

Zgjerimi i NATO-s në Evropën Juglindore⁸ ka filluar me pranimin⁹ e Sllovenisë (2004), më pas Kroacisë dhe Shqipërisë (2009). Politika e

⁸ Evropa Juglindore

⁹ Procesi i aderimit:

1. Bisedimet e pranimin me një grup të NATO-s
2. Të ftuarit dërgojnë letrat e mirëkuptimit tek NATO, së bashku me afatet kohore për përfundimin e reformave
3. Protokollet e aderimit janë nënshkruar nga vendet e NATO-s
4. Protokollet e aderimit janë ratifikuar nga vendet e NATO-s

NATO-s e dyerve të hapura, bazuar në Nenin 10¹⁰ (Traktati i Atlantikut të Veriut 1949) lejon çdo vend të bashkohet me Aleancën dhe ka për qëllim të promovojë stabilitetin, bashkëpunimin dhe vlerat demokratike. (Zgjerimi 2015)

Në çështjet e stabilitetit, NATO ka luajtur një rol të rëndësishëm në operacionet e mbështetjes së paqes në Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni dhe në Kosovë. NATO ka qenë operacioni kryesor i mbështetjes së paqes në Kosovë që nga viti 1999. KFOR-i ishte në gjendje të çmilitarizonte UÇK-në (Ushtria Çlirimtare e Kosovës) dhe Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit i dha mandatin për t'i dhënë fund dhunës së kryer nga Slobodan Milošević. NATO mbështet gjithashtu Marrëveshjen e ndërmjetësuar nga BE ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. (Roli i NATO-s në Kosovë 2016)

NATO ka luajtur gjithashtu një rol kyç në zbatimin e Marrëveshjes së Dejtonit për paqe nëpërmjet misionëve paqeruajtëse për një periudhë 9-vjeçare nga viti 1995 deri në vitin 2004. Sot Bosnje-Hercegovina aspirojnë për anëtarësim në NATO. Mbështetja për stabilitetin

5. Sekretari i Përgjithshëm fton anëtarët e mundshëm të rinj të aderojnë në Traktatin e Atlantikut të Veriut

6. Të ftuarit aderojnë në Traktatin e Atlantikut të Veriut në përputhje me procedurat e tyre kombëtare

7. Pas depozitimit të instrumenteve të tyre të aderimit pranë Departamentit Amerikan të Shtetit, të ftuarit bëhen zyrtarisht anëtarë të NATO-s

¹⁰ Neni 10: Palët, (.....), mund të ftojnë çdo Shtet tjetër evropian në një pozitë të tillë që të nxisë më tej parimet e këtij Traktati dhe të kontribuojë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut që të aderojnë në këtë Traktat. (Traktati i Atlantikut Verior)

institucional, politik dhe të mbrojtjes të vendit janë objektivat kryesore të Aleancës. (Marrëdhëniet me Bosnjën dhe Hercegovinën 2015)

Është e qartë, se vlerat e deklaruara në Nenin 10 nuk janë vetëm një mjet ndihmës për të arritur stabilitetin, por edhe një mundësi e mirë për të ruajtur paqen në të gjithë rajonin. Deri tani Shqipëria është i vetmi vend i BP6 (Ballkani Perëndimor 6), i cili u bashkua me Aleancën, por në të ardhmen e afërt Mali i Zi do të jetë një tjetër vend. Maqedonia nuk arriti të hyjë në NATO për shkak të vetos greke në vitin 2008, kështu që Shkupi mbetet së bashku me Bosnjën dhe Hercegovinën një kandidat potencial. (Marrëdhëniet me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2016)

Mali i Zi është në procesin e anëtarësimit në NATO. Më 19 maj 2016, Ministrat e Jashtëm të NATO-s nënshkruan protokollin e anëtarësimit me Malin e Zi. (Ministrat e Jashtëm të NATO-s nënshkruajnë protokollin e anëtarësimit me Malin e Zi 2016) Aderimi i Malit të Zi në Aleancë është një “shenjë e qartë se vendet e NATO-s vazhdojnë të ndërtojnë stabilitetin dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor” (Jens Stoltenberg). (Euractiv.com 2016) Mali i Zi është duke vazhduar bisedimet e para-anëtarësimit me BE-në, ky proces është i dobishëm dhe duke hyrë në NATO, do të ketë një efekt pozitiv politik, jo vetëm për vendin, por edhe për të gjithë rajonin. Një anëtarësim i suksesshëm në NATO do të japë një rëndësi strategjike rajonale për NATO-n dhe

mund të forcojë stabilitetin afatgjatë të rajonit.¹¹ (Nicolini és Lorenz 2015)

2. Tabela: Statusi i anëtarësisë në NATO i vendeve BP6

Vendi	Anëtarësimi në NATO	Statusi i Vendi Kandidat
Shqipëria	Anëtar që nga 2009	-
Bosnje - Hercegovina	—	Kandidat
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	—	Kandidat
Mali i Zi	Në pritje për ratifikim	-
Kosova	—	-
Serbia	—	Nuk dëshiron të bashkohet

4. Zgjerimi i NATO-s dhe Ballkani Perëndimor: Proces Transformimi apo Aleancë Efikase? – Pas Samitit të Varshavës

Për shkak të sjelljes së kohëve të fundit të Rusisë në vitet e fundit, në Evropë mund të vërehet një situatë e re gjeopolitike: në njërën anë,

¹¹ Nëse vendet e BP6 nuk do të jenë në gjendje të bashkohen me BE dhe NATO, është e sigurtë se Rusia do të depërtojë në këtë vakum.

Moska refuzon partneritetin dhe nga ana tjetër, përpiqet të bllokojë zgjerimin e Bashkimit Evropian dhe NATO-s. (Nicolini és Lorenz 2015) Është e qartë, se qeveria Ruse e drejtuar nga Vladimir Putin është vënë një përpjekje për të ruajtur status quo-në në Evropën Lindore dhe Juglindore. Prandaj anëtarësimi i mundshëm në NATO-s në Ballkanin Perëndimor nuk është më në varësi të vendeve, por edhe në një mosmarrëveshje në kushtet e politikës brenda Aleancës si një e tërë. Pyetja kryesore është se zgjerimi i NATO-s duhet të vazhdojë si një proces progresiv i transformimit të Evropës Juglindore, ose duhet të fokusohet në efikasitetin. (Kamp 2015 4)

Në këtë mënyrë, Samiti i Varshavës kishte një objektiv shumë të rëndësishëm: mos humbjen e Malit të Zi (dhe as rajonin e Ballkanit Perëndimor).

Anëtarësimi i Malit të Zi në NATO do të tregojë se konsolidimi dhe transformimi i Ballkanit Perëndimor ndodh si një proces i tërë. Ky konsolidim nuk mund të vazhdohet nëse pjesa tjetër e vendeve nuk do të bashkohet me Aleancën.¹² (Milinkovich 2016)

Megjithatë, lodhja nga zgjerimi e provuar në BE dhe mungesa e progresit të zgjerimit në vitin 2012 në NATO, mund të japin disa arsye për të ri-konsideruar integrimin e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor në Komunitetin Euro Atlantik.

¹² Serbia mund të jetë një përjashtim.

Pas paraqitjes të rëndësisë kryesore të anëtarësimit, nuk duhet harruar një tjetër pikë e rëndësishme. Nëse njerëzit në Ballkanin Perëndimor nuk e perceptojnë integrimin Euro Atlantik si një alternativë më të mirë për ta, as anëtarësimi në BE ose NATO, nuk mund të jetë i suksesshëm. Megjithatë, partitë dhe qeveritë në pushtet në ditët e sotme janë angazhuar për integrimin dhe në sajë të demokracisë të BE-së, që mbështeten nga votuesit të cilët gjithashtu duan që vendet e tyre të arrijnë statusin e anëtarësimit.¹³

Në fund, mënyra e vetme për integrimin Euro-Atlantik për të zënë rrënjë është nëse njerëzit në Ballkanin Perëndimor e shohin atë si alternativë më të mirë. Kjo nwnkupton fokusimin në ruajtjen ankesën e institucioneve të BE-së dhe duke e mbajtur gjallë vlerat që kanë qenë në qendër projektin e integritit euro-atlantik. (Mylonas 2012 1-5)

Por pyetja është se çfarë do të ndodhë pasi Mali i Zi të fitojë anëtarësimin e plotë në Aleancë?

Është e mundshme që pas anëtarësimit të Malit të Zi në NATO, do të ketë një pauzë të zgjerimit si në BE edhe në NATO. Përkundër konfliktit të interesave ndërmjet vendeve të NATO-s dhe Ruisë, mund të thuhet se Mali i Zi-të dhe anëtarësimit të vendeve të tjera të BP6 në Aleancë mbetet një pikë shumë e rëndësishme kyç në transformimin

¹³ Ndoshta çështja e anëtarësisë së Malit të Zi në NATO mund të jetë përjashtimi i vetëm. Disa Malazezë po ndajnë identitetin me Serbët, të cilë po refuzojnë aderimin në Aleancë.

dhe në procesin e integritetit Euro Atlantik. Ruajtja e stabilitetit dhe paqes në një zonë të pasluftës është gjithmonë e më e rëndësishme se sa interesat e pushtetit afatshkurtër.

Nga perspektiva e rajonit, bashkëpunimit rajonal ka ndikuar në çështjet e stabilitetit, si edhe çështje të tjera të integritetit. Mund të konsiderohet si një sukses i madh që paqja e qëndrueshme është e pranishme në të gjithë rajonin (edhe pse ka incidente jo të rregullta). Gjithashtu sistemet politike demokratike janë krijuar në të gjitha vendet BP6. Kjo do të thotë se stabilizimi ishte një proces i suksesshëm në dy dekadat e fundit. Megjithatë, ky stabilizimin është ende i brishtë. Debatet e fundit, kriza dhe incidentet tregojnë se kohëzgjatja e këtyre rezultateve të jashtëzakonshme mund të mbetet e përhershme vetëm nëse ekziston një politike dhe një vullnet social. Mmund të thuhet, se procesi i stabilizimit asociimit mund të jetë një histori suksesi për BE-në dhe për NATO-n gjithashtu.

Kjo dëshmon elementin e parë të PSA. Elementi i dytë, anëtarësimi është dëshmuar nga integriteti i Kroacisë në Bashkimin Evropian. Kjo tregon arsyen e ekzistencës së Procesit të Stabilizimit Asociimit. (Lőrinczné Bencze 2013 122) Efektet e bashkëpunimit rajonal janë qartësisht të perceptueshme në rajon.

Në lidhje me vendet e BP6, në këtë moment stabilitet është një rezultat i madh. Çështja e anëtarësimit është një proces në vazhdimësi me

shumë pengesa. Është shumë e rëndësishme të theksohet, se bashkëpunimi rajonal mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse burimet e konflikteve mund të zgjidhen në mënyrë paqësore.

Përveç kësaj, qeveritë duhet të trajtojnë probleme ekonomike; prandaj ngadalësia e reformave mund të jetë e mundimshme.

Politika e sigurisë, çështjet politike dhe ekonomike janë duke formuar një rreth vicioz, i cili mund të shkaktojë sfida të vazhdueshme për vendet e BP6.

Në tërësi, marrëveshjet rajonale në Ballkanin Perëndimor kanë paraqitur mundësitë dhe kushtet në të njëjtën kohë. Kjo është një mundësi, sepse këto marrëveshje mund të sigurojnë zhvillimin dhe kapjen e procesit të rajonit. Dhe kusht, për shkak se bashkëpunimi rajonal është një parakusht i rëndësishëm i anëtarësimit në BE të vendeve të BP6.

Bibliografia

Börzel, Tanja A., and Thomas Risse. Diffusing (Inter-) Regionalism. The EU as a Model of Regional Integration. Berlin: Freie Universität Berlin, 2009.

Braun, András. „Regionális megállapodások a Nyugat-Balkánon.” In Távol és közel, az elmúlt 25 év területi folyamatai, szervezetei, intézményei, ahogy az új generáció látja.”, szerző:

Petra Kecskés és Judit Berkes, 8-15. Győr: Széchenyi István University, 2015.

Check current status. 2016. 1 27.

http://ec.Evropa.eu/enlargement/countries/check-current-status/index_en.htm#pc (Consulting: 2016. 7 20).

Delević, Milica . „Regional coopeartion in the Western Balkans.” Insitute for Security Studies, 2007.

Enlargement. 2015. 12 3.

http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49212.htm (Consulting: 2016. 7 23).

EU relations with the Western Balkans.

http://eeas.Evropa.eu/western_balkans/index_en.htm (Consulting: 2016. 7 20).

Euractiv.com. Montenegro becomes NATO's 29th member. 2016. 5 19.

<https://www.euractiv.com/section/global-europe/news/montenegro-becomes-natos-29th-member/> (Consulting: 2016. 7 23).

European Commission - Enlargement - IPA. 2012.

http://ec.Evropa.eu/enlargement/policy/glossary/terms/ipa_en.htm (Consulting: 2016. 7 20).

European Commission. Western Balkans and Turkey: enlargement process key to strengthened economic and political stability in the region. 2015.

11 10. http://Evropa.eu/rapid/press-release_IP-15-5976_hu.htm (Consulting: 2016. 7 23).

Kamp, Karl-Heinz . „The agenda of the NATO summit in Warsaw.” Security Policy Working Paper No. 9, 2015: 5.

Kemenszky, Ágnes. A nyugat-balkáni uniós stratégia fejlődési irányai: stabilizáció és / vagy csatlakozás? .

<http://www.grotius.hu/doc/pub/TFWKXA/77%20kemenszky%20agnes.pdf> (Consulting: 2016. 7 23).

- Lőrinczné Bencze, Edit. Horvátország a függetlenség kikiáltásától az uniós csatlakozásig. Budapest: Aposztróf, 2015.
- Milinkovich, Viktor. NATO enlargement in the Western Balkans. 2016. 6 29. <http://katehon.com/article/nato-enlargement-western-balkans> (Consulting: 2016. 7 23).
- Mylonas, Harris. The Future of Euro-Atlantic Integration in the Western Balkans. New Approaches to Research and Security in Eurasia, 2012.
- NATO Foreign Ministers sign Accession Protocol with Montenegro. 2016. 5 19. http://www.nato.int/cps/en/natohq/news_131132.htm (Consulting: 2016. 7 23).
- NATO's role in Kosovo. 2016. 6 20. http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm? (Consulting: 2016. 7 23).
- Nicolini, Mário, & Wojciech Lorenz. NATO Enlargement: Will Warsaw Deliver? 2015. <http://www.ceid.hu/nato-enlargement-will-warsaw-deliver/> (Consulting: 2016. 7 23).
- Overview - Instrument for Pre-accession Assistance. 2016. http://ec.Europa.eu/enlargement/instruments/overview/index_en.htm (Consulting: 2016. 7 21).
- Relations with Bosnia and Herzegovina. 2015. 12 8. http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49127.htm (Consulting: 2016. 7 23).
- Relations with the former Yugoslav Republic of Macedonia. 2016. 4 7. http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_48830.htm (Consulting: 2016. 7 23).
- Stabilisation and Association Agreement. 2012. http://ec.Europa.eu/enlargement/policy/glossary/terms/saa_en.htm (Consulting: 2016. 7 23).

Stabilisation and Association Process – SAP. 2014. 11 19.

<http://www.eu.me/en/2014-11-19-11-15-23/item/283-stabilisation-and-association-process-sap> (Consulting: 2016. 7 15).

Stabilisation and Association Process. 2012.

http://ec.Evropa.eu/enlargement/policy/glossary/terms/sap_en.htm
(Consulting: 2016. 7 16).

The North Atlantic Treaty. Washington: NATO, 1949.

Vasović, Aleksandar, & Justyna Pawlak. EU brokers historic Kosovo deal,
door opens to

Serbia accession. 2013. <http://www.reuters.com/article/us-serbia-kosovo-eu-idUSBRE93I0IB20130419> (Consulting: 2016. 7 21).

NGA KËRCËNIMI HUMANITAR NË ATË TË SIGURISË: MIT APO REALITET?

Daniel TRENCHOV

I. Hyrje

Megjithëse migracioni dhe terrorizmi janë dy fenomene të ndryshme, të dyja janë rrjedhoja të drejtpërdrejta të konflikteve të dhunshme të armatosura të dy dekadave të fundit në Ballkan, Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut apo Afganistan.

Fluksi i madh i refugjatëve që largohen nga zonat e konfliktit të ndezur në Siri, Irak apo Afganistan e vunë sërish rajonin e Ballkanit Perëndimor në ekranet e mediave botërore siç ka ndodhur më shumë se 20 vjet më parë gjatë konflikteve të post-Jugosllavisë apo 15 vjet më parë gjatë krizës së Kosovës. Përveç ekspozimit në media, Ballkani Perëndimor është kthyer në agjendën e BE-së duke i kujtuar politikëbërësve të botës, analistëve gjeopolitikë dhe përfaqësuesve të BE-së që Ballkani është një qendër e rëndësishme gjeo-hapësinore që mund të harrohet për pak kohë, por sigurisht që nuk mund të injorohet përgjithmonë. Duke luajtur rolin e një portieri të Evropës dhe një “digë e refugjatëve”, as Ballkani Perëndimor nuk është imun ndaj zhvillimeve që po ndodhin.

Pavarësisht sfidave të shumta që vendet e Ballkanit Perëndimor përballen sot në nivelin demokratik, ekonomik dhe politik, ata po përballen edhe me një sfidë tjetër - atë humanitare. Por, ndërmjet krizës humanitare dhe sulmit terrorist në Francë që pretendohet të jetë ekzekutuar nga refugjatët, ekziston një lidhje migracion - radikalizim. Në këto kushte, duket se kriza humanitare mund të konsiderohet në të njëjtën kohë një krizë të sigurisë, para së gjithash për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe më pas për të gjithë Evropën. Megjithatë, sulmet e fundit terroriste në shumë pika të rëndësishme në të gjithë Evropën hedhin poshtë pretendimin se Ballkani është “djepi” i grupeve terroriste dhe një burim kryesor i ekstremizmit të dhunshëm në Evropë.

Nga ana tjetër, përveç të qenit një tokë pjellore në formimin e celulave terroriste për shkak të pozitës gjeografike, institucioneve të dobëta, nivelit të lartë të korrupsionit, kapacitetet e ulëta shtetërore dhe shtetit ligjor të dobët, Ballkani mbetet deri diku i qetë. Megjithatë, terrorizmi në rritje në nivel botëror dhe rajonal së bashku me fluksin e migracionit/refugjatëve, përfaqësojnë të dyja kërcënim humanitar dhe të sigurisë. Në të ardhmen, çështja e migracionit/refugjatëve sikurse edhe rritja e ekstremizmit do të jetë një provë për strukturën e BE-së, por edhe për solidaritetin, gatishmërinë politike, mekanizmat vendimmarrës dhe vendosmërinë e saj për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme, të suksesshme dhe të përhershme.

II. Ndikimi i krizës së migracionit/refugjatëve në vendet e Ballkanit Perëndimor

Kriza e refugjatëve/migracionit ka pasur dhe ka ende një ndikim të madh në sigurinë, politikën, ekonominë dhe kulturën e të gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor. Disa vende të këtij rajoni janë tashmë anëtarë të NATO-s¹, të tjerët janë në rrugën e duhur për t'u anëtarësuar me të drejta të plota në NATO² dhe/apo BE³, të tretët⁴ kanë mbetur mbrapa në përpjekje për të zëvendësuar aspiratat me progres të dukshëm. Pavarësisht stadit të arritur në shkallën drejt anëtarësimit në strukturat euro-atlantike, pavarësisht kapacitetit demokratik të treguar gjatë dy dekadave e gjysmë dhe pa lënë mënjane arritjet e dukshme në nivele të ndryshme, Ballkani Perëndimor është goditur rëndë nga fluksi më i madh i refugjatëve dhe emigrantëve që nga Lufta e Dytë Botërore. Fluksi i madh i refugjatëve ka shkaktuar sfida dhe probleme serioze në vendet pritëse dhe ka ndikuar gjerësisht vendet e tranzitit. Presioni i madh strukturor, financiar, logjistik dhe i sigurisë ka prekur shumë prej vendeve të tranzitit, veçanërisht vendet përgjatë “rrugës Ballkanike”⁵.

¹ Shqipëria dhe Kroacia u anëtarësuan në NATO në vitin 2009.

² Ftesa për anëtarësim iu dërgua Malit të Zi në dhjetor 2015 gjatë takimit të Këshillit të Atlantikut të Veriut. Pas ratifikimit të vendimit për anëtarësim në të gjitha parlamentet e vendeve të NATO-s, Mali i Zi do të bëhet shteti i 29-të anëtar i NATO-s.

³ Serbia dhe Mali i Zi janë të vetmet vende të BP që kanë filluar tashmë negociatat për anëtarësim në BE.

⁴ Shqipëria dhe Maqedonia janë të vetmet vende kandidatë për anëtarësim në Be që nuk kanë nisur negociatat për anëtarësim, ndërsa Kosova dhe BiH janë kandidatë potencialë që kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE-në.

⁵ Balkan SAYS – raport vjetor 2015

Në të ashtuquajturën “rrugë Ballkanike”⁶ dy vende nga Ballkani Perëndimor, Maqedonia dhe Serbia janë prekur më së shumti nga kriza. Në fillim Maqedonia luajti një rol të vogël, duke shërbyer vetëm si vend kalimtar për refugjatët për në Evropën Perëndimore. Duke regjistruar emigrantët dhe refugjatët në kufirin e saj jugor me Greqinë, dhe duke i orientuar ata drejt kufirit verior me Serbinë, Maqedonia ka ndjerë ndikimet negative të kësaj krize menjëherë pas fluksit të parë të madh të refugjatëve në vitin 2015. Meqenëse ka pasur tashmë përvojë në përballimin e katastrofave humanitare, zhvendosjen e njerëzve dhe lëvizjet e mëdha të popullsisë (me krizën në Kosovë në vitin 1999, kur Maqedonia strehoi 250.000 refugjatë kosovarë), vendi u gjend duke luftuar përsëri me një tjetër krizë refugjatësh. Ndryshe nga ajo e mëparshme e vitit 1999, kur Maqedonia ishte një destinacion dhe tani një vend tranzit, kjo krizë u bë shumë shpejt një barrë e konsiderueshme financiare për buxhetin kombëtar.

Me 12 milionë euro⁷ në total të shpenzuara për krizën e refugjatëve vetëm në vitin 2015 dhe 8%⁸ e buxhetit të ushtrisë e shpenzuar për sigurimin e kufijve, Maqedonia nuk ishte në gjendje për të përballuar numrin në rritje të refugjatëve, veçanërisht në periudhën kur vendi përballej me një krizë të vazhdueshme politike dhe probleme

⁶ Një korridor nga Greqia në Maqedoni dhe pastaj përmes Serbisë në kufijtë me Hungarinë dhe Kroacinë duke i lejuar refugjatët të arrijnë destinacionet përfundimtare në Evropën Perëndimore dhe Veriore.

⁷ Të dhënat e marra nga artikulli “Maqedonia dhe bota përballen me krizën e refugjatëve”, më datë 02.01. 2016, Alfa TV

⁸ Të dhënat e marra nga një deklaratë e Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë.

financiare. Nga pikëpamja politike, Maqedonia e konsideroi krizën e migracionit një mundësi të vlefshme për të shfrytëzuar pozitën e saj gjeografike për ofertën e anëtarësimit dhe për të ri-aktualizuar status quo-në e integritit të saj në BE, duke shpresuar se devijimi nga agjenda e reformave të BE-së mund të anashkalohet për hir të stabilitetit dhe bashkëpunimit në frenimin e numrit të refugjatëve që vijnë në BE. Edhe pse nuk është një lojtar kryesor në krizën e përgjithshme humanitare siç ishte Turqia, Maqedonia ka tërhequr vëmendjen pozitive të publikut botëror. Megjithatë, për shkak të krizës së vazhdueshme politike, paaftësisë institucionale dhe mangësive diplomatike, koha e favorshme në rrugën drejt anëtarësimit të plotë në BE ka kaluar me kohë. Nga ana tjetër, pavarësisht presionit të heshtur nga Brukseli për të hapur kampet e refugjatëve, Maqedonia vuri në dispozicion objektet e saj vetëm si pika kontrolli për regjistrimin e emigrantëve dhe asgjë më shumë.

Më e madhe se Maqedonia në çdo parametër, Serbia ishte gjithashtu një nga vendet kryesore të tranzitit për refugjatët në rrugën e Ballkanit që u godit menjëherë nga kriza e emigrantëve. Nëse Maqedonia ishte korridori i parë për refugjatët para se të niseshin për në BE (Greqi), Serbia ishte korridori fundit para se të ri-hynin në BE (Hungari ose Kroaci).

Ashtu si Maqedonia, kriza e refugjatëve në vitin 2015 i kushtoi Serbisë 13-15 Euro⁹ për refugjat që është një shifër e madhe duke pasur parasysh se Serbia lejoi të kalojnë nëpër territorin e saj më shumë se 760.000 refugjatë¹⁰. Ndhima financiare e BE-së për Serbinë dhe Maqedoninë arriti në më shumë se 20 milionë euro¹¹ që ishte më se e mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet financiare të nevojshme për të përballuar krizën. Nga pikëpamja politike, kriza e refugjatëve u menaxhua me sukses nga autoritetet serbe të cilët nuk lejuan të ndodhë ndonjë incident serioz gjatë regjistrimit në pikat e kontrollit. BE-ja e konsideroi Serbinë një partner të besueshëm në menaxhimin e krizave në shkallë të gjerë.

Barra e pranimit të refugjatëve ka rënë në mënyrë disproporcionale në vende të ndryshme të Ballkanit Perëndimor. Pjesa tjetër e vendeve të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Kosova, BiH dhe Mali i Zi, mbetën të paprekur nga kriza apo ajo kishte një ndikim të pakët mbi to. Shqipëria qëndroi vigjilente gjatë gjithë kohëzgjatjes së krizës sidomos pas mbylljes së rrugës së Ballkanit. Kryeministri shqiptar ka deklaruar se vendi i tij *“nuk do të jetë një rrugë e re për refugjatët në rrugën e tyre*

⁹ Sipas artikullit “Gde je uzrok krize zbog migranata” nga Zejnel Zejneli, datë 27. 07.2015 <http://www.intermagazin.rs/gde-je-uzrok-krize-zbog-migranata/> (marrë më datë 20. 07. 2016)

¹⁰ Sipas agjencisë kufitare të BE FRONTEX, 764,000 refugjatë dhe azil kërkues nga Siria, Afganistani dhe Iraku udhëtuar përmes Maqedonisë dhe Serbisë në 2015 për të vijuar me tej në ishujt e Egjeut për në Gjermani dhe pjesët e tjera të Evropës Perëndimore.

¹¹ Ndryshe nga Serbia dhe Maqedonia që si vende jo anëtare të BE së bashku kanë marrë më shumë se 20 milion euro mbështetje financiare, Greqia dhe Kroacia si vende të BE kanë marrë rreth 700 milion dhe 21 milion euro respektivisht.

për në Evropë (e cila mund të jetë përmes Adriatikut për në Itali), për shkak se i mungojnë kushtet, forca dhe entuziazmi për të shpëtuar botën, ndërsa të gjithë të tjerët po i mbyllin kufijtë e tyre”¹². Ngjashëm me këtë deklaratë, Kryeministri malazez ka bërë të ditur se vendi i tij “do të duhet mbyllë mbyllur kufijtë e tij, nëse Maqedonia e mbyll kufirin me Greqinë”¹³. Megjithatë, si Shqipëria edhe Mali i Zi filluan me përgatitjet për pritjen e deri në 10.000 refugjatëve duke ish strukturat ushtarake në qendra pritje.

Gjithashtu kriza e emigrantëve ka ndikuar në mënyrë të pashmangshme marrëdhëniet e fqinjësisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kriza ishte një provë për marrëdhëniet ndërmjet të gjitha vendeve përgjatë rrugës së migrimit dhe ajo kishte një ndikim shumë kompleks. Nga njëra anë, për shembull, Maqedonia dhe Serbia koordinuan veprimet e tyre pa gjeneruar llojin e tensioneve të cilat dëmtonin bashkëpunimin kufitar në mes të shteteve të tjera¹⁴. Nga ana tjetër, çështja e përforcimit të kontrolleve kufitare ka pasur pasoja negative në marrëdhëniet dypalëshe në rajon që prekin marrëdhëniet Kroate / Serbe.

Mungesa e komunikimit ndërmjet qeverive dhe lëvizjet e njëanshme i përkeqësuan me shpejtësi marrëdhëniet. Njëfarë dëmi u bë dhe, për shembull, marrëdhëniet Serbo-Kroate u përkeqësuan ndërsa zënka

¹² Raport i asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës – Të drejtat e njeriut të refugjatëve dhe emigrantëve – situata në Ballkanin Perëndimor - 2015

¹³ Ibid.,

¹⁴ Lange, Sabina. The Western Balkans: back in the EU spotlight, European Union Institute for Security Studies (EUISS), March 2016

dypalëshe u shoqërua me një fushatë agresive në media, sidomos në Serbi¹⁵. Marrëdhëniet ndërmjet Shkupit dhe Athinës ishin të tensionuara gjithashtu, ku qeveria maqedonase fajësonte Greqinë që nuk kishte bërë një punë të mirë në kontrollin e migracionit në BE¹⁶. Nga ana tjetër, kryeministri grek akuzoi Maqedoninë se po “turpëronte Evropën” pasi policia maqedonase ndaloi një përpjekje të emigrantëve për të kaluar kufirin. Në fakt, marrëdhëniet e fqinjësisë mund të përkeqësohen nëse rruga e Ballkanit riaktivizohet.

Në lidhje me ndikimin e marrëveshjes BE-Turqi mbi situatën në vendet e Ballkanit Perëndimor, nuk ka dyshim se pas nënshkrimit të marrëveshjes më 18 mars 2016, presioni në rajon ka rënë. Periudha para miratimit të marrëveshjes dhe para mbylljes së rrugës ballkanike u shënua me ndryshime të rëndësishme në kuotat e pranimi ndërmjet vendeve pritëse të refugjatëve. Në shkurt 2016, Austria shpalli dhe alarmoi vendet e Ballkanit se do të shqyrtonte vetëm 80 kërkesa për azil çdo ditë dhe se do të vendosë një kufi maksimal vjetor prej 37.500 kërkesash. Për rrjedhojë, të gjitha vendet përgjatë rrugës ballkanike mbyllën kufijtë e tyre dhe disa prej tyre vendosën trupat ushtarake për të siguruar kufirin nga kalimi i paligjshëm. Asnjë nga shtetet e Ballkanit nuk donin të rrezikonin që refugjatët mund të bllokoheshin dhe të mbeteshin në vendet e tyre.

¹⁵ Policy Brief, Western Balkans and the EU: Beyond the Autopilot Mode

¹⁶ <http://www.sharqforum.org/2016/06/08/europes-refugee-crisis-and-the-balkans/> (accessed on 18.07.2016)

Me anë të nënshkrimit të marrëveshjes, Turqia u angazhua për të marrë mbrapsht “për një periudhë të përkohshme” të gjithë refugjatët dhe emigrantët që do të mbërrijnë në të ardhmen në ishujt grekë - me kusht që për çdo refugjat sirian të marrë mbrapsht, një tjetër do të zhvendosej nga Turqia në BE. BE-ja u angazhua t’i jepte 3 miliardë euro ndihmë financiare shtesë për përpjekjet e Turqisë në mbështetje të refugjatëve sirianë gjatë tre viteve të ardhshme, për të çuar përpara udhëtimin pa viza në vendet e Shengenit për qytetarët turq dhe për të përshpejtuar negociatat e anëtarësimit të Turqisë në BE¹⁷. Megjithatë, nëse marrëveshja prishet, që nisur nga rrethanat e tanishme ka shumë gjasa që të ndodhë për shkak të rënies së dukshme të demokracisë pas përpjekjes për grusht shteti dhe Ballkani Perëndimor do të paguajë çmimin për këtë. Nëse shifrat rriten sërish dhe presioni gjithashtu, është e qartë se rajoni i Ballkanit Perëndimor ngjiten një herë dhe presioni fillon në rritje përsëri, është më se e qartë se rajoni i Ballkanit Perëndimor me pozicionin e tij si ndërmjetës, të gjendur në mes të dhunës në Lindjen e Mesme dhe Evropës Perëndimore, do të shërbejë edhe një herë si dera e përparme e Evropës.

Lidhja mes Terrorizmit dhe Migracionit në Ballkanin Perëndimor

Terrorizmi modern karakterizohet nga teknika të ndryshme që terroristët përdori duke filluar nga ato tradicionale në moderne,

¹⁷ Raport i asamblesë parlamentare ë Këshillit ë Evropës – Të drejtat e njeriut të refugjatëve dhe emigrantëve – situata në Ballkanin Perëndimor - 2015

asimetrike në hibride apo reale në kibernetike. Duke qenë tradicionalisht një udhëkryq i njerëzve të cilit i shtohen kufijtë e pasigurta, institucionet e dobëta, qeveritë e paqëndrueshme, korrupsioni mbyttës, tensionet e përhershme etniko-fetare dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme territoriale, Ballkani Perëndimor përbën një terren të përshtatshëm për radikalizëm, duke i hapur rrugën grupeve terroriste për të kaluar lehtësisht nga Evropa për në Siri dhe anasjelltas.

Pajisja lehtësisht me pasaporta dhe dokumente në vendet e Ballkanit mundëson kalimin e thjeshtë të kufirit dhe lëvizjen nëpër kontinentin evropian¹⁸. Qindra persona kanë lënë Ballkanin për të luftuar kundër regjimit të Asadit në konfliktin në Siri që prej vitit 2012 të cilët së bashku me ato të Evropës Perëndimore dhe ato nga pjesë të tjera të botës formojnë një shifër të jashtëzakonshme 25.000 deri 30.000¹⁹ luftëtarë të huaj, që janë me origjinë nga më shumë se 100 vende, për të luftuar për kauzën e ISIS “. Pas përfitimit të përvojës luftarake, ata përbëjnë një kërcënim serioz për vendet e origjinës duke rritur shanset për radikalizim dhe përhapjen e ekstremizmit në rajon. Në mbështetje të këtij pretendimi është edhe Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 2178 e miratuar në shtator të vitit 2014, e cili thotë se luftëtarët e huaj terroristë rrisin intensitetin, kohëzgjatjen dhe rëndësinë e konflikteve, si dhe mund të përbëjnë një kërcënim serioz për Shtetet e tyre të origjinës, Shtetet ku ato kalojnë dhe Shtetet për ku udhëtojnë. Sipas disa vlerësimeve mbi luftëtarët nga BP të dhëna nga

¹⁸ Raport nga Forumi i Qendrës Marshall për Sigurinë, Transnational threats: NATO and national response, 2015

¹⁹ Vlerësimet e Kombeve të Bashkuara

OKB-ja në gusht të vitit 2014, ka pasur rreht 130 luftëtarë nga Kosova, rreth 70 nga Maqedonia, 50 luftëtarë me origjinë nga BiH, 42 nga Shqipëria dhe shumë pak nga Serbia. Në bazë të këtyre statistikave, vendet e Ballkanit Perëndimor mund të jenë një burim potencial i luftëtarëve islamikë dhe një strehë për të kthyerit nga zonat e luftës në Siri dhe Irak.

Ndonëse dihen parakushtet për t'u larguar nga Ballkani dhe për të luftuar në Siri, arsyet pse individët zgjedhin të bëhen militantë janë të paqarta. Lidhjet fetare dhe historike, afërsia me rajonin e Sirisë, mbështetja aktive e celulave në rajon, zona urbane e luftës dhe kombinimi i këtyre faktorëve mundësojnë ekstremistët islamikë të Ballkanit Perëndimor që jo vetëm të marrin pjesë aktivisht, por edhe të jenë të mbështetje operative financiare dhe logjistike për grupet në tranzit²⁰. Në lidhje me arsyet, rasti i mjekut të ri nga Maqedonia i cili u largua nga vendi për të luftuar për ISIS, dëshmon natyrën komplekse të këtyre arsyeve. Ai pretendonte se kishte shkuar në Siri për arsye ideologjike dhe se ana financiare nuk ishte shtysa e tij kryesore e radikalizmit, por ideologjia fetare duke u konvertuar nga ortodoks në besimtar islam. Megjithatë, policia konfirmoi se në shumicën e rasteve arsyet ishin thjesht me qëllim fitimprurës duke pasur parasysh se një sasi e madhe parash është paguar në mënyrë të vazhdueshme për mbështetësit e ISIS për veprimet e tyre.

²⁰ Raport nga Forumi i Qendrës Marshall për Sigurinë, Transnational threats: NATO and national response, 2015

Por, ku qëndron lidhja këtu ndërmjet kërcënimeve terroriste dhe krizës së refugjatëve/ emigrantëve? Për sa i përket Ballkanit Perëndimor, ka pak prova që konfirmojnë lidhjen terrorizëm /refugjatë. Megjithatë, mos ekzistenca e provave të forta nuk do të thotë që mungon rreziku i radikalizmit. Përkundrazi, hetimi i sulmeve terroriste në Paris tregoi se organizatori kryesor - një qytetar belg hyri në Evropë i fshehur në mesin e mijëra refugjatëve që kalonin përmes Greqisë. Në bazë të pasaportës së falsifikuar e gjendur në vend-ngjarje, një prej terroristëve u kthye në BE nga Siria nëpërmjet Greqisë, Maqedonisë dhe Serbisë, ku ai ishte regjistruar si refugjat. Me fjalë të tjera, terroristët udhëtuan së bashku me refugjatët, duke u “maskuar” si refugjatë. Fakti se të paktën një prej terroristëve të sulmeve në Paris kishte hyrë në BE përgjatë rrugës ballkanike tregon se fenomeni i islamikëve “të fjetur” nuk duhet nënvlerësuar në kontekstin e migracionit²¹.

Gjithashtu, në shtator 2015, Qendra Hungareze Kundër-terrorizmit njoftoi se terroristët po kalonin kufijtë të maskuar si refugjatë, duke shkaktuar shqetësime serioze për sigurinë kombëtare²². Nga maji deri në tetor 2015, janë raportuar vetëm tre raste në mënyrë të detajuar që përfshin terroristë xhihadistë të “maskuar” si refugjatë. Megjithatë, rasti i parë i raportuar tashmë është diskredituar, ndërkohë ka ende pyetje në lidhje me dy të tjerët²³. Në fakt, sulmet terroriste në Paris, bombardimet

²¹ Jureković, Predrag. The International Refugee Crisis as a Challenge for the Western Balkans, IFK Monitor International, February 2016

²² Lito, Melina, International Human Rights Accords protect Migrants from Discrimination, Journal of European Security and Defense Issues, vol.7, issue 1, 2016

²³ Ibid.,

vetëvrasëse në Bruksel dhe sulmi më i fundit i kamionit në Nisë nxorën në pah se islamistët ekstremistë të brezit të dytë ose të tretë që kanë lindur ose janë rritur në shoqëritë perëndimore dhe të cilët kanë nënshtetësi perëndimore (që i mundëson atyre lëvizjen e lirë në të gjithë BE-së) kanë më shumë gjasa që të rekrutohen për të ekzekutuar sulme terroriste se sa refugjatët. E thënë ndryshe, dështimi i tanishëm për integrimin e emigrantëve në vendet e tyre siguron terren të favorshëm për ekstremizmin në të ardhmen. Në mbështetje të kësaj deklarate janë statistikat e OKB-së të cilat tregojnë se nga 1.2 milion²⁴ refugjatë gjithsej të cilët kanë hyrë në BE në vitin 2015, vetëm 37 dyshohen refugjatë terroristë, ose 0.004%. Nënshkrimi i marrëveshjes BE-Turqi mund të bëhet një shqetësim më shumë për shërbimet e sigurisë perëndimore pas heqjes së vizave për qytetarët turq. Kjo do të thotë që nëse Turqisë i hiqen vizat e udhëtimit për në BE në përputhje me dispozitat e përcaktuara në marrëveshje, atëherë ekziston mundësia që terroristët e ISIS të hyjnë ligjërisht në BE duke përdorur pasaporta turke. Sipas këtij skenari, shanset për ekzekutimin e sulmeve terroriste në qendrat evropiane do të rriteshin në mënyrë eksponenciale.

Rreziku i radikalizmit është gjithmonë i mundshëm sidomos kur ekstremistët përzihen me civilët që po largohen nga zonat e konfliktit. Pavarësisht nga ekzistenca e terroristëve në grupet e refugjatëve, rreziku i konvertimit të një refugjati në një ekstremist mund të ndikohet

²⁴ Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin, mbi 1.2 milion emigrantë jo ë rregullt dhe refugjatë mbërritën në Evropë në vitin 2015, shumica nga Siria, Afrika dhe Azia Jugore.

nga shumë faktorë të tjerë si vendosja gjeografike dhe statusi ligjor i refugjatëve, niveli i mbështetjes sociale dhe ekonomike nga popullsia vendase, politikat dhe veprimet e vendit pritës dhe kohëzgjatja e krizës. Sa më shumë të zgjasë kriza e refugjatëve, aq më i madh është rreziku i radikalizimit.

Ndikimi i Vendeve të Ballkanit Perëndimor në Krizën e Migracionit/Refugjatëve – Bashkëpunimi Ndërshtetëror në Trajtimin e Kërcënimeve Humanitare dhe të Sigurisë

Vendet e Ballkanit Perëndimor po përballen me sfidën e se si t'i përgjigjen kërcënimeve të reja humanitare dhe të sigurisë. Disa nga vendet kanë zhvilluar një kuadër strategjik të qëndrueshëm për t'u përballur me këto kërcënime, ndërsa të tjerët janë ende duke ndërtuar kapacitetet institucionale për të njëjtin qëllim. Përvoja nga terreni tregon se reduktimi i rrezikut të radikalizmit dhe zbutja e sfidës humanitare kërkon bashkëpunim në nivele të shumëfishta dhe shkon përtej sigurimit të një mbështetje humanitare të përshtatshme dhe të qëndrueshme. Në fakt, ajo kërkon një qasje me shumë nivele që konsiston në një sërë masash dhe aktiviteteve siç janë: kontrolli i identifikimit, menaxhimi i vlerësimit të informacionit, bashkëpunimi ndërinstitutional, inteligjenca njerëzore, shkëmbimi i informacionit, ndarja e përvojës, monitorimi i fluksit të refugjatëve, fokusi i të përbashkët në zbatimin e ligjit, kontrolli më i madh i kufirit, kontrolli i vazhdueshëm i mediave sociale, metodat e ndalimit të udhëtimit të

terroristëve, mbështetje humanitare, luftë kundër trafikimit të refugjatëve, etj.

Ky lloj bashkëpunimi konsiderohet si i domosdoshëm ndërmjet shërbimeve të sigurisë dhe ato civile dhe të tjera. Prandaj, në aspektin e shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit ndërmjet shërbimeve homologe, vendet e Ballkanit Perëndimor, sidomos ata më të prekur nga kriza, kanë caktuar pika kontakti, kanë përgatitur raporte për flukset migratore, kanë bashkëpunuar ngushtë me Frontex dhe kanë ndarë vlerësimet e nevojave. Sa i përket kapaciteteve pritëse, vendet janë angazhuar për ngritjen e qendrave pritëse shtesë dhe pikave të kontrollit në rast se situata përshkallëzohet, në pajisjen e strehëzave ekzistuese me ndihmën e organizatave humanitare, si Kryqi i Kuq apo Gjysmëhëna e Kuqe, për rritjen e kapaciteteve pritëse, etj. Sa i përket menaxhimit të kufirit dhe luftës kundër trafikimit, janë shkëmbyer pajisje teknike kufitare, janë ndërmarrë aktivitete të përbashkëta për regjistrimin e refugjatëve, është dakordësuar mekanizmi i mbrojtjes civile, është formuar një task forcë për sigurimin e informacionit, është miratuar legjislacioni i ngjashëm (që i lejon refugjatët të kalojnë lirshëm përmes vendeve për një periudhë të caktuar kohore), është shkëmbyer informacion mbi lëvizjet e trafikantëve të mundshëm, transportimi i refugjatëve nga qytetarët vendas është ndaluar dhe janë aktivizuar masa të tjera për bashkëpunimin.

Me gjithë përpjekjet e dukshme, reagimi kombëtar dhe bashkëpunimi rajonal mungojnë ende. Mangësitë për zbatimin e duhur së bashku me kapacitetet e pazhvilluara të shërbimeve kanë penguar efektivitetin në

shkallë të gjerë që ka të bëjë me krizën. Dallimet në kapacitetet e shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe përgjigja rajonal e pa harmonizuar kanë ndikuar negativisht. Për të zbutur kërcënimin humanitar, shumë angazhimeve mbeten ende për t'u ndërmarrë si përmirësimi dhe zgjerimi i kapaciteteve pritëse, njoftimi i fqinjëve në lidhje me politikën ose masat e planifikuara, përmirësimi i dialogut ndërmjet shërbimeve, mundësimi i vendosjes së mbështetjes Frontex, kërkimi i përbashkët i burimeve për shtretër, akomodim, veshje, ngrohje dhe pajisje mjekësore. Përveç aspektit humanitar, shkëmbimi i inteligjencës ndërmjet agjencive do të rrisë shanset e zbulimit të terroristëve të mundshëm që kalojnë në Ballkan të “maskuar” si refugjatë dhe do të parandalojë rekrutimin e refugjatëve. Gjithashtu, shkëmbimi efikas i informacionit mbi të dyshuarit për terrorizëm do të rrisë monitorimin e kontrolleve kufitare dhe do të mbajë nën vëzhgim sulmet e mundshme të ekstremistëve të krahut të djathtë. Është e domosdoshme pasja e një kuptimi më të saktë të lidhjeve ndërmjet migracionit masiv dhe terrorizmit në vendet e Ballkanit dhe forcimi i bashkëpunimit të qëndrueshëm midis partnerëve rajonalë²⁵.

Mungesa e aksesit në fondet e BE-së që i alokohen zakonisht anëtarëve të tij për situatat e emergjencës si kjo dhe pa pasur leje për të përdorur

²⁵ Meçe, Merita H. Irregular Migration Flows and Human, Trafficking In the Western Balkan Countries:

Challenges of the Convergence of Counter, Trafficking Response, *Journal of Liberty and International Affairs*, vol 1, 2016

bazën e të dhënave Eurodac²⁶, është koha e duhur për vendet e Ballkanit Perëndimor që të fillojnë të ndjekin shembullin e BE-së për ndërtimin e kapaciteteve institucionale shtesë. Krijimi i një qendre ballkanike për luftën kundër terrorizmit, rritja e kontrollit të armëve, vendosja e kontrolleve më rigoroze për pasagjerët në aeroporte mund të jenë pika të mira referimi.

Pasojat e Mundshme të Krizës së Migracionit/Refugjatëve; Implikimet sipas Këndvështrimit Humanitar dhe të Sigurisë

Sipas disa ekspertëve dhe praktikantëve, krizat e refugjatëve janë zgjidhur tradicionalisht në tre mënyra: 1. Zgjidhja e konfliktit fillestar në vendin e origjinës dhe kthimin e refugjatëve në shtëpitë e tyre, 2. Vendosja përfundimtare e refugjatëve në vendet pritëse, ndoshta me një mundësi për shtetësinë dhe 3. Rivendosja e refugjatëve në vendet e treta .

Skenari i parë i pasqyruar në krizën e tanishme të migracionit / refugjatëve është më i miri, por edhe skenari më pak i mundur vetëm për shkak të zhvillimeve në terren. Duke pasur parasysh pritshmëritë e ulëta për t'i dhënë fund luftës në Siri që është ndezur që nga viti 2011 dhe duke marrë parasysh 4 milion refugjatë të cilët kanë lënë tashmë vendin duke u përpjekur për të arritur në Evropën Perëndimore, kriza humanitare nuk do të përfundojë së shpejti. Megjithëse territori i kalifatit të ISIS është në rënie në sajë të veprimeve ushtarake dhe

²⁶ Eurodac është baza e të dhënave e BE për identifikimin e aplikantëve për azil duke përdorur thjesht shenjat e tyre ë gishtërinjve.

sulmeve ajrore të NATO-s dhe Rusisë, statusi aktual i një vendi të rrënuar nuk jep shpresë për të ardhmen. Njerëzit nuk do të reshtin së larguari dhe ata që janë larguar tashmë nuk do të kthehet më. Megjithatë nëse kriza e zbutet dhe ISIS shkatërrohet, atëherë të gjitha kapacitetet humanitare dhe të sigurisë do t'i alokohen vendit në mënyrë që të ndihmohet të rivendoset paqja dhe të vendosen themelet për rindërtimin e shtetit. Vendet e Ballkanit Perëndimor reshtin së qeni zona tampon mes Lindjes së Mesme dhe pjesës tjetër të Evropës pa u prekur nga pasojat e mëtejshme humanitare ose të sigurisë.

Skenari i dytë kësaj krize të emigrantëve është që të gjithë refugjatët do të vendosen përgjithmonë në vendet pritëse të BE-së. Ndonëse të dhënat demografike të BE-së tregojnë nevojën për punëtorë të huaj për të forcuar zëvendësuar fuqinë punëtore në plakje, norma e përbashkët e papunësisë ishte vetëm nën 10 për qind në fillim të vitit 2016. Nuk është ende koha që të zgjerohet sektori i papunësisë duke shtuar refugjatët në grupin e punëkërkuësve²⁷. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është supozimi se një pjesë e madhe e refugjatëve përbëhet nga punëtorë të pakualifikuar të cilët nuk mund të integrohen lehtësisht në mjedisin e ri.

Përkundër deklaratave se të gjithë refugjatët do të shpërndahen në mënyrë proporcionale ndërmjet vendeve të BE-së, impakti i të “sapo të ardhurve” do të jetë masiv në aspektin politik, ekonomik, kulturor dhe shoqëror në përgjithësi. Me fjalë të tjera, refugjatët dhe azilkërkuësit e

²⁷ Zeneli, Valbona and W. Vann, Joseph. A burden on the Balkans, Concordian, vol,7, issue 1, 2016

shumtë si jo-evropianë me identitete të ndryshme fetare dhe kulturore do të vështirësojnë më tej situatën në vendet pritëse.

Kjo ka gjasa ta bëjë zhvendosjen më sfiduese në nivel lokal dhe mund të dekurajojë vendet nga pranimi i më shumë refugjatëve²⁸. Nga pikëpamja e sigurisë, nëse politikat e integritetit janë të pasuksesshme, vendosja e refugjatëve mund të krijojë kushte për radikalizimin e mundshëm në vendin e ri të jetesës. Qeliza të tjera terroriste mund të formohen dhe mund të krijohen lidhje ndërmjet radikalëve të “vjetër” dhe të “rinj”. Vendet e Ballkanit Perëndimor sipas këtij skenari do të mbesin vende tranziti duke rrezikuar të shpenzojnë burime të konsiderueshme financiare. Të qenit një vend tranzit për një kohë të gjatë mund të lërë pasojë të rënda në shumë nivele.

Skenari i tretë i cili parashikon zhvendosjen e refugjatëve në vendet e treta do të ishte shkatërrimtar për vendet e BP. Që nga fillimi i krizës emigrantëve, vendet e BP zgjodhën opsionin e bashkimit të përpjekjeve me BE-në në trajtimin e krizës, edhe pse ishte opsion më i kushtueshëm, më i vështirë se sa lënia refugjatëve të kalonin kufirin. Megjithatë, në rrethanat ku qindra e mijëra azilkërkues që përpiqen të arrijnë në BE të ngelen në BP, atëherë e gjithë situata do të shndërrohet në një katastrofë humanitare dhe të sigurisë në shkallë botërore. Një numër i madh i personave të zhvendosur, përshkallëzimit të shpejtë të varfërisë, shkelja e të drejtave të njeriut, nxitja e tensioneve dhe konflikteve ndëretnike do të jetë imazhi i ri i BP. Me fjalë të tjera, në

²⁸ Ibid.,

një rajon që ka tashmë një situatë të rëndë ekonomike, politike dhe shoqërore dhe në mungesë të mjeteve dhe kapacitetit për t'u përballur me krizën në këtë përmasë të gjerë, ndikimi i popullsive të refugjatëve në shtetet e brishta të Ballkanit do të jetë në përmasa të pandreqshme. Nëse liderët dhe politikëbërësit evropianë nuk arrijnë të vlerësojnë dhe të marrin masa parandaluese për t'u përballur me këtë krizë, kjo do të destabilizonte të gjithë kontinentin evropian. Sipas parimit të efektit domino, pasojat mund të jenë një valë shumë më e madhe azilkërkuesish, por kësaj here do të shoqërohet me një numër të madh të shtetasve të Ballkanit Perëndimor gjithashtu.

Përfundime

Përthithja e një numri të madh refugjatësh dhe emigrantësh për çdo vend nuk është e lehtë. Kjo është e qartë tashmë edhe në vendet që janë destinacion si Austri, Gjermani apo Suedi, ku një sasi e madhe burimesh është shpenzuar për strehimin e të ardhurve, por edhe për të parandaluar të ardhur të tjerë. Megjithëse me infrastrukturë të zhvilluar mirë, ekonomi të qëndrueshme, histori të gjatë në respektimin e shtetit të së drejtës, qeverisjes së mirë dhe institucioneve të forta, vendet e destinacionit ende përpiqen në këtë krizë humanitare. Kriza i ka treguar për politikanëve evropianë dhe popullsisë së BE-së se sa pak të përgatitur ishin ato për të menaxhuar dhe për të absorbuar fluksin e refugjatëve, azilkërkuesve dhe emigrantëve të paligjshëm ekonomikë. Në kaosin e korridoreve të institucioneve të BE-së, BE-ja ka kuptuar se e ka theksuar rolin qendror të Ballkanit Perëndimor në ruajtjen e

kufijve të BE-së. Rruga e Ballkanit Perëndimor shpejt u bë porta më e përdorur për të hyrë në Evropë për emigrantët e parregullt, por edhe për terroristët e mundshëm. Përfshirja e personave në sulmet terroriste në Paris, Bruksel, Nisë dhe që u hynë në BE si refugjatë, vetëm konfirmojnë realitetin e lidhjes së migracionit – terrorizmit.

Të provokuar nga propaganda e rekrutuesve islamikë, refugjatët mund të radikalizohen lehtësisht dhe kthen lehtësisht në një kërcënim të sigurisë për vendin e destinacionit, por edhe për vendet e tranzitit. Duke qenë një rrugë për mijëra emigrantë dhe refugjatë, vendet e Ballkanit testuan kapacitetet e tyre institucionale për të përballuar një krizë të madhe. Të detyruar nga presioni i fluksit të madh të njerëzve, Maqedonia dhe Serbia, vendet më të ekspozuara gjatë kësaj rruge, kanë shpenzuar burime të konsiderueshme për të menaxhuar krizën, por edhe për të mbrojtur kufijtë e BE-së. Kjo ka nxjerrë në pah zbuluar absurditetin e vendeve të Ballkanit Perëndimor që nuk janë në BE. Qindra mijëra refugjatë lanë një vend të BE-së / Shengen për të kaluar përmes dy vendeve jashtë BE-së për tu rifutur në BE. Bashkëpunimi ndërmjet vendeve të BP është vendosur duke u fokusuar në bashkëpunimin ndërinstitutional, monitorimin e refugjatëve, duke parandaluar udhëtimin e terroristëve të mundshëm, kontrollin e identitetit, etj.

Kjo krizë humanitare ka treguar gjithashtu se bashkëpunimi më i madh me BP dhe investimi në kapacitete në BP nga ana e BE-së është shumë i nevojshëm dhe i pritshëm meqenëse kjo krizë, për shkak të natyrës së saj, është shumë më evropiane se sa vetëm krizë e BE-së. Për shkak të

përgjigjes të pakësuar ndaj krizës dhe përkeqësimi i imazhit në marrëdhëniet ndërkombëtare i provokuar nga Brexit është i domosdoshëm krijimi i një qasjeje të përbashkët, gjithëpërfshirëse të BE-së duke përfshirë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor lidhur me azilin dhe migracionin. Askush nuk mund të parashikojë se kur apo nëse do të përfundojë kriza e migracionit/refugjatëve, por duke pasur parasysh dinamikën e luftës në Siri, konfliktet e pazgjidhura në Afganistan dhe Irak, pikat e nxehta të mundshme në Afrikë, rënien e demokracisë në Turqi dhe rikonfigurimin e dukshëm gjeopolitik në hartën e sigurisë botërore, kjo krizë është vetëm fillimi i një fatkeqësie më të madhe humanitare apo të sigurisë, kjo është qetësia para stuhisë.

Bibliografia

Annual report, 2015, Balkan SAYS

Barbara Sude, David Stebbins & Sarah Weiland, *Lessening the Risk of Refugee Radicalization*, Perspective

Hatidža Beriša, Katarina Jonev & Igor Barišić, 2016, The Influence of Islamic State on the Global Security, *Journal of Liberty and International Affairs*, vol 1

Jureković, Predrag. 2016, *The International Refugee Crisis as a Challenge for the Western Balkans*, IFK Monitor International

Lange, Sabina, 2016, *The Western Balkans: back in the EU spotlight*, European Union Institute for Security Studies (EUISS)

- Lito, Melina, 2016, International Human Rights Accords protect Migrants from Discrimination, *Journal of European Security and Defense Issues*, vol.7, issue 1
- Meçe, Merita H., 2016, Irregular Migration Flows and Human, Trafficking In the Western Balkan Countries: Challenges of the Convergence of Counter, Trafficking Response, *Journal of Liberty and International Affairs*, vol. 1
- Policy Brief, *Western Balkans and the EU: Beyond the Autopilot Mode*
- Report by the Parliamentary Assembly of the Council of Europe, 2015, *Human Rights of Refugees and Migrants – the Situation in the Western Balkans*
- Report by the European Commission, *Managing the Refugee Crisis - Western Balkans Route: State of Play Report*, Western Balkans Route: State of Play Report
- Report from the Marshall Center Security Forum, 2015, *Transnational threats: NATO and national response*
- Zeneli, Valbona & W. Vann, Joseph. A burden on the Balkans, *Concordian*, vol.7, issue 1, 2016
- <http://frontex.Evropa.eu/> (accessed on 19.07.2016)
- <http://www.iom.int/> (accessed on 20.07.2016)
- <http://www.sharqforum.org/2016/06/08/europes-refugee-crisis-and-the-balkans/> (accessed on 20.07.2016)
- <http://www.alfa.mk/News.aspx?id=103957#.V5XEntJ94dU> (accessed on 18.07.2016)

http://ec.Evropa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/asylum/identification-of-applicants/index_en.htm(accessed on 20.07.2016)

NJË VËSHTRIM MBI FUSHËN E SIGURISË KIBERNETIKE NË SHQIPËRI

Eranda BEGAJ

Studiuese

I. Hyrje

Përhapja e shpejtë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit¹ në mbarë botën ka sjell përfitime të mëdha ekonomike dhe mundësi zhvillimi për njerëzimin. Megjithë mundësitë që përçon, TIK mbart edhe rrisje serioze për mbarë shoqërinë. Kujtojmë se i gjithë aktivitetit ynë i përditshëm, mbështet në mjetet TIK, që së bashku me efektet pozitive përbën një mjedis të lakmuar për aktivitet kriminal, si krimi kibernetik dhe kërcënimet për infrastrukturën kritike të rrjetit të informacionit. etj.

Për këtë qëllim komuniteti ndërkombëtar ka krijuar autoritetet e nevojshme për të investiguar krimin kibernetik, gjithashtu ka forcuar kapacitetet njerëzore për të luftuar këtë lloj të ri krimi. Shtetet e zhvilluara po i kushtojnë vëmendje gjithnjë e më të madhe mbrojtjes së hapësirës kibernetike, si pjesë e sigurisë kombëtare.

Ndërkohë, në Shqipëri penetrimi i internetit në të gjithë territorin e vendit, zhvillimi i infrastrukturës TIK, informatizimi i shoqërisë,

¹ Me poshtë do i referohem me akronimin "TIK"

promovimi i qeverisjes elektronike kanë qenë sfida të vazhdueshme të shoqërisë dhe autoriteteve shqiptare. Në këtë këndvështrim, investimet e ndërmarra i kanë dhënë lulëzim ndërveprimit të databasave shtetërore dhe ofrimit të shërbimeve publike online. Sot çdo qytetar shqiptarë lehtësisht mund të përfitoj shërbime publike tërësisht online, zhvillim i të cilës e vendos edhe me shume theksin në rëndësinë që i duhet kushtuar fushës së sigurisë kibernetike.

Në këtë kuadër dhe duke kujtuar të gjithë rëndësinë dhe kompleksitetin që mbart siguria kibernetike në shoqërinë shqiptare më poshtë do të analizojë zhvillimin e kësaj fushe në realitetin shqiptarë. Hapat e ndërmarra nga autoritetet shtetërore në forcim të kapaciteteve njerëzore për të mundësuar luftën e suksesshme ndaj këtij lloji të ri krimi. Gjithashtu me shumë rëndësi është edhe analizimi i kuadrit ligjor të krijuar për këtë qëllim.

II. Digjitalizimi në Shqipëri

Shqipëria sikurse në shumë vende të tjera, ka qenë dëshmitare e zhvillimit të shpejtë të internetit. Ky zhvillim vërehet qoftë në aktivitetin e përditshëm të administratës publike qoftë dhe në aktivitetin e sektorit privat tregtar. AKEP² vlerëson se përgjatë tremujorit të parë të vitit 2016 numri i pajtimtarëve me akses në internet nga rrjete fikse është 246, 675 pajtimtarë. Ndërkohë për të njëjtën periudhë kohore,

² http://akep.al/images/stories/AKEP/statistika/2016/numri_i_pajtimareve_me_akses_broadband_fiks.pdf

numri dhe penetrimi i pajtimtarëve me akses broadband 3G dhe 4G është 49.2%³.

Komunikimet elektronike dhe shpërndarja e internetit kanë mundësuar dhe kontribuar në krijimin e një kulture digjitale në Shqipëri. Kulturë, e cila facilton përthithjen e politikave të ndërmarra nga qeveria shqiptare në kudër të krijimit të qeverisjes elektronike dhe ofrimit të shërbimeve publike online. Gjithashtu, politikat aktuale të qeverive shqiptare janë fokusuar në ngritjen e sistemeve elektronike, informatizimin e shoqërisë, krijimin e platformës kombëtare të ndërveprimit e cila aktualisht mundëson shkëmbimin në kohë reale të informacionit të mbartur nga autoritetet qeveritare. Për më tepër politikat aktuale kanë mundësuar ofrimin e shërbimeve publike tërësisht online. Shqipëria renditet në vendet e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor për nivelin e digjitalizimit të shërbimeve publike. Një eksperiencë e akumuluar me krijimin për herë të parë të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vitin 2007. Krijimi i kësaj Agjencie për herë të parë në Shqipëri, nxiti dhe promovoi vlerat e qeverisjes elektronike. Nëpërmjet kësaj Agjencie u hodhën bazat për krijimin e një shoqërie digjitale shqiptare. Në çdo institucion linje u krijuan departamentet e Teknologjisë së Informacionit, të cilat jo vetëm koordinojnë punën në aspekte mirëmbajtje rrjeti/infrastruktura por mbi të gjitha janë përçuese të projekteve TIK. Kjo skeme e zgjedhur ka çuar në centralizimin e

³ Burimi AKEP

këtij procesi, një aspekt shumë i rëndësishëm për zhvillimin e duhur dhe të qëndrueshëm të kësaj fushe.

Gjithashtu mjaft e rëndësishme të theksohet është edhe mbështetja politike që i është ofruar këtij sektori. Zhvillimi i politikave dhe implementimi i projekteve TIK patjetër kërkojnë mbështetje politike dhe leadership të fortë për të asimiluar projektet mjaft ambicioze të propozuara në këtë fushë. Në këtë këndvështrim Shqipëria ka zbatuar projekte mjaft ambicioze krahasuar me nivelin e zhvillimit shoqëror dhe kulturën digjitale.

Implementimi i suksesshëm i këtyre projekteve lidhet në mënyrë të padiskutueshme edhe më nivelin e zhvillimit të arritur nga shoqëria. Projekte si “SMART CITIES”; e-leja, e-edukimi, e-shëndetësia, e-taksa, e-dogana, e-prokurimi janë patjetër të lidhura me kulturën digjitale të komunitetit.

Kujtoj se vetëm për vitin 2015, qeveria shqiptare ka financuar mbi 180 projekte TIK për të gjitha institucionet e linjës. Nën këtë kornizë, siguria e këtyre sistemeve të ngritura merr një dimension vital për mbarëvajtjen e këtij sistemi të ri të krijuar. Autoritet shqiptare duhet të kenë nën fokus të veçantë çështjen e sigurisë kibernetike dhe sigurisë së informacionit, për funksionin jetik që paraqet për çdo qytetar shqiptarë.

III. Politikat dhe Strategjia Kibernetike

Në Shqipëri politikat e para në fushën e sigurisë kibernetike datojnë në vitin 2002. Kohë në të cilën Shqipëria ratifikoi Konventën Kibernetike të Këshillit të Evropës⁴. Me ratifikimin e kësaj Konvente lindi nevoja urgjente që autoritetet Shqiptare të përmbushnin detyrimet që rrjedhin nga kjo konventë. Implementimi i kësaj konvente është mjaft kompleks pasi kërkon përshtatjen e kuadrit ligjor shumë sensitive. Megjithatë autoritetet shqiptare nisën punën për implementimin e duhur të detyrimeve që sjell ratifikimi i kësaj konvente duke propozuar ndryshimet e nevojshme ligjore.

Konventa e Këshillit të Evropës, ka në fokus kryesor të saj, bashkëpunimin dhe harmonizimin për veprat kriminale. Për këtë qëllim ekstradimi është ndër konceptet bazë që konventa përcjell për luftën kundër krimit kibernetik. Për këtë qëllim propozimet e nevojshme u hartuan në Kodin Penal duke pasur në mëndje harmonizimin e këtij kodi me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Këshillit të Evropës. Në këtë kuadër mbas një analize gjithëpërfshirëse autoritetet shqiptare miratuan ndryshimet në legjislacionin e mëposhtëm:

- ❖ Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i amenduar;
- ❖ Ligji 7905 datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurave Penale të Republikës së Shqipërisë” i amenduar.

⁴ Ligj Nr. 8888, datë 25.4.2002 Për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”

Në vijim të ndryshimeve të sjella nga legjislacioni i mësipërm, për herë të parë konsiderohet krim, veprat penale të kryera në fushën e teknologjisë së informacionit. Më poshtë po paraqes veprat penale në fushën e teknologjisë së informacionit ta parashikuara në legjislacionin penal shqiptar:

- ❖ Shpërndarja kompjuterike e materialeve pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit;
- ❖ Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik;
- ❖ Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik;
- ❖ Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik;
- ❖ Mashtrimi kompjuterik;
- ❖ Falsifikimi kompjuterik;
- ❖ Hyrja e paautorizuar kompjuterike;
- ❖ Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike;
- ❖ Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike;
- ❖ Ndërhyrja në sistemet kompjuterike;
- ❖ Keqpërdorimi i pajisjeve.

Nga ana tjetër me qëllimin harmonizimin e plotë me legjislacionin ndërkombëtar në këtë fushë, në vitin 2004 Shqipëria ratifikoi

protokollin shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik⁵, për penalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

Gjithashtu, në kudër të proceseve integruese dhe detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit⁶ (MSA), Shqipëria është angazhuar të përmbush të gjithë detyrimet që rrjedhin nga ky proces. Duke kujtuar se neni 70 i kësaj marrëveshje kërkon përshtatjen e legjislacionit të brendshëm shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian, rrjedhimisht ky detyrim lind edhe për fushën e sigurisë kibernetike. Në këtë kuadër përafrimi me *acquis* e Bashkimit Evropian në praktikat e brendshme merr një dimension të rëndësishëm. Autoritet shtetërore duhet të kenë veçanërisht në fokus përafrimin me Direktivën 2008/114 “Mbi identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre, “Programin Evropian për mbrojtjen e infrastrukturës kritike (EPCIP) “

Gjithashtu përafrimi i standardeve të vendosura nga Direktiva 2013/40/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian “Mbi sulmet kundrejt sistemeve të informacionit” duhet të ndiqen nga autoritetet shqiptare. Shqipëria duhet të ndjek të gjitha ndryshimet dhe rregullimet në nivel

⁵ Ligjin Nr. 9262, datë 29.7. 2004 “Për ratifikimin e “Protokollit shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik, për Penalizimin e Akteve me Natyrë Raciste dhe Ksenofobe të Kryera Nëpërmjet Sistemeve Kompjuterike”

⁶ Miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”

evropian jo vetëm si kërkesë e këtij procesi por edhe si një praktikë e mirë në këtë fushë. Për këtë qëllim propozimet e Komisionit Evropian nëpërmjet draft-direktivës “Mbi rrjetet e sigurisë së informacionit” duhet të përqasen edhe nga autoritet shqiptare, duke qenë se ky propozim do të vendos standarte të larta në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të besueshëm digjital.

Ndërkohë që në Bashkimin Evropian ekzistojnë mjaft dokumente strategjik⁷ për rregullimin e kësaj fushe hapat e ndërmarra në Shqipëri janë akoma në faza të para. Aktualisht në Shqipëri nuk ekziston një strategji në fushën e sigurisë kibernetike. Mjaft diskutime po zhvillohen në këtë kuadër, megjithatë vizioni i qeverisë shqiptare për këtë fushë duhet të jetë më i qartë. Megjithëkëtë qeveria shqiptare ka miratuar dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015-2017⁸. Nëpërmjet këtij dokumenti përcaktohet vizioni dhe objektivat e zhvillimit për periudhën 2015-2017 si dhe jepen drejtimet kryesore të politikave që do të ndiqen për realizimin e një hapsirë kibernetike të sigurt.⁹ Dokumenti mbështetet në modelet dhe praktikat më të mira evropiane, përsa i përket objektivave dhe zgjidhjeve të parashikuara, gjithnjë duke marrë në konsideratë karakteristikat specifike të shoqërisë dhe ekonomisë shqiptare.

⁷ Përmendim këtu Strategjinë e Bashkimit Evropian në Sigurinë Kibernetike; Agjenda Evropiane për Sigurinë; Kuadri Politik mbi Mbrojtjen Kibernetike në BE.

⁸ VKM Nr. 973, date 02.12.2015

⁹ Dokumenti i politikave për sigurinë kibernetike 2015-2017, faqe 10

<http://www.cirt.gov.al/images/dokumenta/Dokumenti%20i%20Politikave%20per%20Sigurine%20Kibernetike%202015-2017.pdf>

Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike (Cyber defense)¹⁰ hartuar nga Ministria Mbrojtjes synon mbajtjen e një mjedisi operimi elektronik të sigurtë, të qëndrueshëm dhe të besueshëm, i cili mbështet sigurinë në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura dhe rrit përfitimet e mjedisit dixhital për to; vendosjen e standardeve për përdorimin e sigurt të hapësirës kibernetike; inkurajimin për një zbatim gjithëpërfshirës; garantimin e sigurisë dhe progresit për strukturat dhe sistemet e ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) të Ministrisë së Mbrojtjes. Strategjia e Sigurisë Kibernetike përshkruan sfidat aktuale në çështje të sigurisë të sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) dhe pikat kryesore me qëllim për të përballuar këto sfida.

Gjithashtu, strategjia ndërsektorale Agjenda Digjitale e Shqipërisë¹¹ 2015-2020, miratuar përgjatë vitit 2015, përbën dokumentin strategjik që përcaktonte drejtimit kryesore dhe objektivat e zhvillimit në fushën e shoqërisë së informacionit për periudhën 2015 –2020. Vizioni i këtij dokumenti strategjik është:

*Një shoqëri e bazuar në dije dhe informacion, nëpërmjet konsolidimit të infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike online dhe rritjes së transparencës së qeverisjes.*¹²

¹⁰ http://www.mod.gov.al/images/PDF/Strategjia_per_Mbrojtjen_Kibernetike.pdf

¹¹ Miratuar me VKM Nr 284 datë 01.04.2015

¹² VKM Nr. 284 datë 01.04.2015 “Për miratimin e Strategjisë Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020” - Faqja 21

Nga ana tjetër Agjenda Digjitale e Shqipërisë vendos objektiva kryesore në fushën e sigurisë kibernetike ku besimi dhe siguria e rrjeteve dhe informacionit janë ndër objektivat bazë që ky dokument synon të realizojë.

Si konkluzion, përqasja e politikave evropiane në legjislacionin e brendshëm si dhe miratimi i menjëhershëm i Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike mbetet një sfidë imediate e autoriteteve qeveritare. Për një hartim dhe implementimi të suksesshëm të politikave në këtë fushë koordinimi i ngushte me të gjithë aktorët është i domosdoshëm. Nga ana tjetër, mjaft e rëndësishme janë kosto financiare që paraqet implementimi i këtyre politikave. Aktualisht autoritetet qeveritare nuk kanë një faturë financiare të nevojshme për të realizuar projektin e madh të një mjedisi online të sigurt dhe të besueshëm.

IV. Legjislacioni Kibernetik Shqiptar

Sikurse përmendur nën pjesën e Politikës dhe Strategjia Kibernetike, legjislacioni i kësaj fushe kryesisht lidhet me ndryshimet e propozuar për kodin penal dhe kodin e procedurave penale. Rregullim i cili erdhi si pasojë e detyrimeve që miratimi i Konventës së Budapestit implikoi për autoritetet shtetërore. Gjithashtu me qëllim rregullimin e mëtejshëm të kësaj fushe mjaft të rëndësishme, qeveria shqiptare përgjatë vitit 2016 ngriti një grup pune me anëtarë të institucioneve kontribuuese në

fushën e sigurisë kibernetike. Grupi punës propozoi për herë të parë draftin ligjin e sigurisë kibernetike. Qëllimi i këtij ligji është arritja e një niveli të lartë të sigurisë kibernetike, duke përcaktuar masat e sigurisë, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve fizikë dhe juridikë si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e sigurisë kibernetike. Ky draft ligj përveç rregullimit teknik të fushës synon edhe rregullimin institucional midis aktorëve kryesor në këtë fushë.

V. Kuadri Institucional

Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (ALCIRT) vepron si skuadra kombëtare për përgjigjen ndaj incidenteve kompjuterike dhe është një strukturë kyçe në nivel kombëtar, e ngarkuar me koordinimin e incidenteve kibernetike dhe përgatitjen e masave për parandalimin e këtyre incidenteve. Agjencia u krijuar për herë të parë në vitin 2011 nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 766, datë 14.9.2011 Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT). Në një analizë paraprake të veprimtarisë së kësaj strukture problematika të shumta vërehen. Mungesa stafit është një problematikë kryesore që e ka shoqëruar këtë strukturë përgjatë veprimtarisë së saj. Mungesa e trajnimeve për stafin ekzistues, mundësia për shkëmbime eksperiencash nëpër agjenci të ngjashme në nivel evropian ose edhe me gjerë ka munguar. Nga ana tjetër mungesa e një buxheti adekuat pengon çuarjen përpara të reformave që i janë mandatuar.

Institucione përgjegjëse për sigurinë kibernetikë në Republikën e Shqipërisë janë si më poshtë:

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), është autoriteti që kontrollon, garanton sigurinë e sistemeve të klasifikuara të komunikimit dhe informacionit dhe bën akreditimin e tyre nëpërmjet lëshimit të Çertifikatës së Sigurisë për këto të fundit.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), është autoriteti që ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit “Për Nënshkrimin Elektronik” dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. AKCE bën akreditimin e ofruesve të shërbimit të certifikimit elektronik.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), është përgjegjëse për administrimin e infrastrukturës qeveritare të Çelësit Publik (PKI) dhe siguron pajtueshmërinë me nenin 19 të ligjit Nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”. Në shërbimet që ofron në Qendrën e të Dhënave Qeveritare, për administratën publike, garanton autentifikim dhe identifikim të sigurtë, internet të sigurtë dhe DNS të sigurtë.

Policia e Shtetit, është organi përgjegjës për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, ndër të cilat përfshihen dhe veprat penale në fushën e TIK, që ndiqen nga Sektori i Kundër Krimit Kompjuterik.

Prokuroria e Përgjithshme, përmes sektorit të krimeve kibernetike ushtron ndjekjen penale për vepra penale në fushën e kibernetikës. Kjo strukturë kontrollon aktivitetin e njësive të posaçme për ndjekjen e krimeve kibernetike, që janë ngritur në prokuroritë e rretheve gjyqësore.

Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), përmes seksionit të Kundër Krimit Kibernetik, ka për detyrë kërkimin, zbulimin dhe analizimin e krimeve kibernetike që cenojnë sigurinë kombëtare.

Ministria e Mbrojtjes, ka rol në ruajtjen e sigurisë kibernetike përmes Drejtorisë së Automatizimit dhe Inovacionit, por edhe institucioneve të përmendura më poshtë në varësi të Ministrit të Mbrojtjes (DSH dhe AISM).

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Drejtoria e Ndërlidhjes, përgjigjet për zhvillimin e Sistemeve të ndërlidhjes dhe të Informacionit (SNI) në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë duke u mbështetur në standardet kombëtare, të NATO-s dhe ato ndërkombëtare.

Drejtoria e Shifrës (DSH), është Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Komunikimeve dhe Autoritet Kombëtar i Shpërndarjes.

Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes dhe Sigurisë (AISM), përmes sektorit të Mbrojtjes Kibernetike dhe Infosec ka si detyrë parashikimin, identifikimin dhe analizimin e kërcënimeve kibernetike që çenojnë sistemet TIK të FASH.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve të elektronike. AKEP-i, mbikëqyr zbatimin e masave të nevojshme të ndërmarra nga sipërmarrësit mbi sigurinë dhe integritetin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike publike në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP), është autoriteti përgjegjës i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale elektronike gjatë ruajtjes, përpunimit dhe transmetimit të tyre, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Rekomandime

Sikurse pamë më lart, zhvillimi i telekomunikacionit, qasja në internet, digjitalizimi dhe informatizimi i shoqërisë ka ecur me hapa galopant. Rritja e komunikimit dhe nivelit të informatizimit përbën një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit tonë. Megjithatë

zhvillimi shpejtë i teknologjive të informacionit dhe komunikimit rrit mundësinë e rrezeqeve me natyrë kibernetike në sektorin publik dhe atë privat. Nga analiza më lart, pamë se praktika e zhvillimit të infrastrukturës TIK është në faza më të përparuara sesa niveli i rregullimit ligjor të kësaj fushe. Në këtë kuadër është e nevojshme që autoritetet shtetërore të krijojnë rregulla që do të ndihmojnë në sigurinë dhe rritjen e besueshmërisë për të gjithë sistemin e informatizimit të krijuar tashmë. Sikurse përmendur edhe më lart, mjaft e nevojshme është që autoritetet të kenë një vizion të qartë ku duan të çojnë nivelin e sigurisë kibernetike në vendin tonë. Për këtë qëllim, Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike duhet hartuar menjëherë. Ngritja e një grupi pune ekspertësh ligjor dhe teknik duhet ndërmarr sa më shpejt për të siguruar hartimin e një strategjie realiste dhe të zbatueshme për nivelin e zhvillimit të arritur deri më tani.

Nga ana tjetër, kuadri institucional në fushën e sigurisë kibernetike është i mirë përcaktuar, megjithatë koordinimi dhe niveli i bashkëpunimit mes institucioneve dhe agjencive të përmendura më lart, mbetet në nivele jo të duhura. Lufta kundër krimit kibernetik dhe menaxhimi i sulmeve të mundshme kërkon një koordinim dhe bashkëpunim të shkëlqyer midis të gjithë aktorëve. Për ALCIRTn mbetet sfida koordinimi midis të gjithë aktorëve dhe për këtë qëllim në opinionin tim zhvillimi i trajnimeve dhe tryezave të përbashkëta nën drejtimin e ALCIRT do të mundësonte dhe ndihmonte në koordinim e duhur të këtij procesi kompleks. ALCIRT duhet të marr një rol lider në

mbikëqyrjen e hapësirës kibernetike shqiptare, dhe bashkëpunimi i ngushtë me të gjithë aktorët e kësaj fushe sikurse edhe me aktorë ndërkombëtar të mundshëm duhet të jetë punë e përditshme e Agjencisë.

Gjithashtu një tjetër problematik që mbetet për tu koordinuar nga ALCIRT është menaxhimi i sulmeve kibernetike. Nga një hulumtim në administratën shqiptare por edhe në sektorin privat rezulton se sulmet kibernetike mbahen të fshehta, dhe rrjedhimisht ka një mungesë informacioni që vështirëson analizimin e këtyre rasteve. Në këtë kuadër, ALCIRT duhet të kryej fushata sensibilizuese për këtë qëllim dhe të vendos ura bashkëpunimi të besueshme me sektorin publik dhe privat.

Bibliografia

Agjenda Evropiane për Sigurinë;

Council Directive 2008/114/EC of 8 December 2008 on the identification and designation of European critical infrastructures and the assessment of the need to improve their protection

Digital Agenda for Europe (DAE)

Draft Ligji për Sigurinë Kibernetike

http://www.cirt.gov.al/dokumenta/Projekt_Ligj_Autoriteti_Kombetare_per_Sigurine_Kibernetike.pdf

http://www.integrimi.gov.al/files/documents_files/16-02-18-12-42-07MSA.pdf

<http://www.cirt.gov.al/images/dokumenta/Dokumenti%20i%20Politikave%20per%20Sigurine%20Kibernetike%202015-2017.pdf>

http://www.mod.gov.al/images/PDF/Strategjia_per_Mbrojtjen_Kibernetike.pdf

Kuadri Politik mbi Mbrojtjen Kibernetike në BE

Ligj Nr. 9590 datë 27.7.2006 Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare

Ligji Nr. 7895, Datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji Nr. 7905, Datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Progres raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë

Regulation (EU) No 526/2013 of the European Parliament and of the Council of 21 May 2013 concerning the European Union Agency for Network and Information Security (ENISA)

Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike

VENDIM Nr. 973, date 02.12.2015 Për Miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë Kibernetike 2015-2017

VENDIM Nr.766, datë 14.9.2011 Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (Alcirt), i Ndryshuar

VKM Nr 284 datë 01.04.2015

VKM Nr 284 datë 01.04.2015 “Për miratimin e Strategjisë Axxhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020”

MIGRACIONI NË VITE DHE PROCESI I RIINTEGRIMIT

Miranda Boshnjaku¹

PhD Kandidat

Shqipëria është një vend me një popullsi të regjistruar mbi 4 milion banorë. Krahësuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë, Shqipëria ka aktualisht përqindjen më të lartë të emigracionit në Evropën Qendrore dhe Lindore. Megjithatë nuk ka statistika të sakta mbi emigracionin, përllogaritet se rreth 25 % e popullsisë shqiptare banojnë jashtë vendit.

Nga ana tjetër, imigracioni zë një përqindje të vogël (rreth 0.2% të popullsisë totale që banojnë në Shqipëri) dhe bazohet kryesisht në imigrimin për motive punësimi.

Vendi

Vendi ka një sipërfaqe prej 28,748 kilometrash katrorë: tokë 27,398 km katrorë dhe ujë 1,350 km katrorë. Kushtetuta e re u miratua më 28 Nëntor 1998.

¹ PhD kandidat, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Tiranë. Drejtorja e Policisë së Shtetit



Gjatësia e përgjithshme e kufirit shtetëror është 1,100 km, nga të cilat 740 km kufi tokësor dhe 360 km kufi detar.

Kufiri me shtetet anëtare të BE:

- Greqia 282 km

Kufiri me shtetet e tjera:

- Republika e Maqedonisë 151 km

- Serbi dhe Mal i Zi 287 km (Serbia 114 km dhe Mal i Zi 173 km, Kosova 2 117 km)³

Përveç imigrantëve për qëllime punësimi, gjatë vitit të fundit është rritur përqindja e imigrantëve për qëllime të ribashkimit familjar apo atyre për qëllime studimi. Ndërkohe, vihet re një ulje e numrit të të huajve rezident për aktivitete humanitare.

Panoramë e shkurtër dhe karakteristikat e migrimit shqiptar jashtë vendit

Migracioni shqiptar fillon që në kohërat e hershme të pushtimit të perandorisë otomane turke, vazhdon gjatë periudhës së krijimit të shteteve të Evropës Juglindore në fund të Shekullit 19 e fillim të atij 20, për të vazhduar në përmasa të konsiderueshme në vitet 1991, 1997 e 1998 dhe mund të grupohet kështu sipas periudhave të zhvillimit:

- Në atë të hershëm apo para luftërave deri në vitin 1944;
- Në migracionin e periudhës së regjimit komunist, 1944 - 1990;
- Atë post komunist 1990 e në vazhdim.

Lëvizjet migratore shqiptare të periudhës së pushtimit otoman kryesisht drejt Italisë shënojnë shpërnguljet më të mëdha të hershme të popullsisë shqiptare⁴. Më pas, Lufta e II Botërore pati një ndikim në lëvizjet çame

² Provincë Autonome nën administrimin e UN që nga 1999

³ (http://www.fact-index.com/g/ge/geography_of_albania.html)

⁴ Arvanitët: Ngulimet shqiptare të Greqisë (të quajtura arvanitë), datojnë nga shekulli i XIV-XV, sidomos pas pushtimit otoman të Shqipërisë. Edhe sot ata ndeshen në njësi

nga Greqia drejt Shqipërisë, sidomos pas marrëveshjes së Lozanës në 1923, në mes Greqisë e Turqisë për shkëmbimin e popullsisë.

Gjatë viteve të regjimit komunist 1944-1990, emigracioni shqiptar përbehej nga individë të cilët largoheshin nga Shqipëria për motive politike, dhe janë vendosur në vende të ndryshme si azilkërkues politik.

Pas ndryshimit të regjimit në vitin 1990, Shqipëria kaloi një periudhë të vështirë dhe të gjatë tranzicioni, gjë që nxiti në mënyrë të menjëhershme emigracionin. Me gjithë rritjen ekonomike dhe stabilitetin politik gjatë viteve 1992-1996, fluksi i emigranteve mbeti i pandryshuar, duke përfshirë këtu edhe emigrante të kualifikuar.

Me vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri, lëvizja e shtetasve shqiptarë jashtë kufijve të shtetit dhe brenda qyteteve të Shqipërisë u bë shumë e vështirë, duke arritur një fazë që lëvizjet e mundshme ndërkufitare ishin ato të kontrolluara rreptësisht nga qeveria. Për shkak të këtij izolimi kishte lëvizje minimale migratore. Shqipëria u përball me fenomenin e emigrimit për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore vetëm në korrik të vitit 1990, kur qytetarët shqiptarë hynë masivisht në ambasadat e vendeve të huaja në Tiranë. Ky akt theksoi gjendjen reale

kompakte si treva shqipfolëse në: Atikë, Korint, Beoti, Peloponez, Argos, Ubese..etj. **Arbëreshët:** Në Itali arbëreshët janë vendosur herët, por pas vdekjes së Skënderbeut vërsjuan valë të tjera prej mijëra refugjatësh që u strehuan nga mbreti Ferdinand i Napolit. Arbëreshët u vendosën në brigjet e Adriatikut, që nga Venediku deri në Pulia, Kalabri dhe Sicili. Rumani dhe Bullgari Nga mesi i shekullit të XIV e më pas u vendosën në Bullgari dhe Rumani. Diaspora shqiptare është e pranishme edhe në bregdetin e Dalmacisë pranë Zares, në Trakën lindore pranë Adrinopojës (Edërne) dhe në Turqinë Aziatike.

të një vendi, në të cilin qytetarët pothuajse nuk kishin të drejta politike dhe ekonomike, në krahasim me vendet e tjera të Evropës Perëndimore dhe madje edhe të atyre që i përkisnin bllokut të Evropës Lindore.

Në kontekstin e ndryshimeve politike në Evropën Lindore, rreth 5000 shqiptarë hynë në ambasadat e vendeve evropiane, ku kërkuan mbrojtje. Pothuajse në të njëjtën kohë, ata që nuk ishin në gjendje për të gjetur rrugën e duhur apo kohën e duhur për të hyrë në ambasadat e vendeve evropiane, filluan të kalonin kufirin tokësor në drejtim të Greqisë, si shteti i vetëm anëtar të BE-së me një kufi të përbashkët me Shqipërinë. Pas disa përvojave të hidhura, të cilat janë shoqëruar edhe me humbje jetësh, kufiri me Greqinë u bë porta kryesore e migrimit shqiptar. Një faktor shtesë ishin atëherë zhvillimet politike që shpesh kanë ndikuar negativisht situatën ekonomike në Shqipëri, ato u bënë një nxitje të mëtijshme për migrim masiv me anije nëpër Detin Adriatik në Itali.

Pavarësisht eksodit masiv në Itali dhe hapjen e mundësive të tjera për migrim në shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian apo edhe në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada, migrimi në Greqi (të dyja i ligjshëm dhe i paligjshëm) mbeti një faktor konstant. Vit pas viti kjo ikje është rritur edhe më tej përmes migracionit të ligjshëm me viza pune dhe përmes ribashkimit familjar, por edhe duke kaluar kufirin me dokumente të falsifikuara për të hyrë kryesisht në BE. Një pjesë e konsiderueshme e emigrantëve të paligjshëm shqiptarë janë ata që kanë përfituar nga amnistitë e ndryshme apo legalizimet duke

mundësuar marrjen e lejeve të qëndrimit në përputhje me politikat e aplikuara nga vendet pritëse. Ndikuar nga punët e brendshme të Greqisë, emigrantët shqiptarë në këtë vend kanë hasur shpesh vështirësi në konvertimin e statusit të tyre ligjor nga emigrantë të parregullt në banorë të ligjshëm, megjithatë, Greqia vazhdon të renditet në vendin e dytë në sigurimin e lejeve të qëndrimit për emigrantët shqiptarë, në krahasim me numrin total të atyre në Bashkimin Evropian. Sipas statistikave të BE-së, rezulton se në Itali qëndrojnë me leje qëndrimi të rregullt rreth 450.000 emigrantët shqiptarë, ndërsa Greqia ka lëshuar rreth 350,000 leje qëndrimi. Vendet e tjera të BE-së janë mjaft jodomethënës në lidhje me kushtet e lartpërmendura në dy vendet, në dhënien e lejeve të qëndrimit për emigrantët shqiptarë.

Mesatarja totale vjetore e lejeve të qëndrimit të parashikuara për shqiptarët në BE është rreth 900 000, megjithatë, duke marrë parasysh legjislacionin evropian mbi lejet e qëndrimit, i cili vendos afate konkrete për ripërtëritjen e këtyre lejeve, duhet të konsiderojmë se numri i aplikimeve vjetore nuk paraqet vetëm numrin e aplikimeve të reja të emigrantëve shqiptarë, por edhe të atyre që rinovojnë çdo vit lejet e qëndrimit. Ky numër i lartë përjashton ata shqiptarë të cilët tashmë kanë marrë shtetësinë e vendeve pritëse.

Megjithatë, bazuar në këto shifra, llogaritja të çon në përfundimin se rreth 1.5 milionë shqiptarë janë vendosur tashmë jashtë vendit.

Pavarësisht nga motivet dhe rastet e ndryshme që kanë shtyrë shumë shqiptarë të emigrojnë në Perëndim, duket se arsyt kryesore për

migrimin e qytetarëve shqiptarë ishin - dhe ende janë - kryesisht lidhur me kushtet ekonomike. Emigrantët shqiptarë kanë për qëllim të përmirësojnë gjendjen e tyre ekonomike dhe duket se shumica e tyre kanë pasur sukses. Shpesh, koha e gjatë që jetojnë jashtë vendit, statusi i fituar ligjor, karriera e mirë profesionale dhe investimet e suksesshme në vendin pritës, i kanë lidhur emigrantët shqiptarë me vendbanimin e tyre të ri, ku ata kanë arritur të ndërtojnë një rrugë për të ardhmen e fëmijëve të tyre duke i integruar në shkolla, kurse dhe punë.

Riatdhesimi i shqiptarëve

Vala e parë e emigrantëve shqiptarë drejt vendeve të botës, është vërejtur nga fqinjët tokësore dhe detare të Shqipërisë, si një shpërthim dramatik i një populli të një vendi të mbyllur dhe krejtësisht të varfër. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre emigrantëve u mbështetën nga strukturat qeveritare, OJQ-të dhe bizneset. Punë e siguruara për shqiptarët në Greqi dhe Itali, ndihmuan ndjeshëm në përmirësimin e situatës ekonomike të emigrantëve dhe gjithashtu mundësuan të drejtën ata që të qëndrojnë në vendet pritëse për një kohë të gjatë.

Si në çdo lëvizje masive dhe të pakontrolluar që ka njohur historia njerëzore edhe në rastin e emigrimit të shqiptarëve, ka pasur sigurisht shumë persona me synime kriminale, të cilët keqpërdoruan mundësitë e afuara, regjimin demokratik të vendeve pritëse duke kryer veprime të kundërligjshme nga të cilat siguruan të ardhura të paligjshme. Por ky numër është shumë i vogël në krahasim me ata emigrantë, të cilët

kërkuan një punë nga e cila siguruan të ardhura të mjaftueshme për familjet dhe një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre në fushën e lirisë. Po fakt është se akoma ka shumë emigrantë që janë në kërkim të një pune dhe mundësie të sistemimit në këto vende duke u bërë në disa raste, një kërcënim për rendin publik. Vlerësimi ndaj emigrantëve shqiptarë gjatë këtij çerek shekulli ka qenë pozitiv dhe negativ, në vite ka pasur oshilacione lidhur kjo edhe me politikat shtetërore. Si pasojë emigrantët shqiptarë, të cilat nuk u asimiluan nga vendet fqinje, janë bërë subjekt i riatdhesimit.

Greqia, duke përfituar nga pozicioni gjeografik dhe kufiri i përbashkët tokësor, ndryshe nga vendet e tjera perëndimore, të cilat kanë kthyer në Shqipëri vetëm personat e konsideruar si një kërcënim, ka aplikuar kthimet e shpeshta. Përveç kthimit të rregullt, të përbërë nga persona që janë konsideruar kërcënim për rendin publik dhe sigurinë, apo persona të cilët kanë punuar pa pasur dokumente të rregullta qëndrimi, shteti grek ka aplikuar edhe metoda si “fshesa”, metoda këto që kanë për qëllim të dekurajojnë emigrantët.

Në periudha të caktuara, të mbingarkuara me emigrantë të parregullt, si dhe me tensione politike ndërmjet Athinës dhe Tiranës, procesi i kthimit të emigrantëve shqiptarë përfshinte jo vetëm rastet e përmendura më lart si kategori të paligjshme, por edhe një numër të konsiderueshëm të shqiptarëve, të cilët kishin hyrë në Greqi me viza të rregullta.

Operacionet greke të quajtura “fshesa”, ishin në këtë kontekst një kombinim i kontrolleve të rrepta brenda vendit në lidhje me vendet e punës ku shqiptarët ishin duke punuar në mënyrë të paligjshme, shpesh për shkak të vonesave të shumta në procesin e lëshimit të lejes së punës e qëndrimit. Megjithatë, afërsia gjeografike, lidhjet njerëzore në të dy anët e kufirit, interesat e përbashkëta të punëdhënësve grekë dhe punëkërkuësve shqiptarë, dallimet e pagave në dy vendet marrëdhëniet shqiptaro - greke akoma e bëjnë Greqinë një vend të synuar për emigrantët shqiptarë.

Por pavarësisht gjithë këtyre kushteve dhe numrit të madh të emigrantëve shqiptarë në Greqi, një marrëveshje ri pranimi midis Greqisë dhe Shqipërisë, në marrëveshjen e ri pranimit midis BE-së dhe Shqipërisë për fat të keq ende mungon.

Me krijimin e sistemeve të informacionit kufitar elektronik dhe zbatimin e tyre në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar të Shqipërisë, kemi një pamje më të qartë lidhur me numrin dhe arsyet e kthimit të emigrantëve. Kjo periudhë sigurisht që është me interes të madh dhe fillon në vitin 2007, kur Shqipëria kishte nënshkruar tashmë marrëveshjen e ri pranimit me BE-në (2006), e cila dha një pasqyrim mbi emigracionin shqiptar në mënyrë më të qartë, duke i ndarë në kategorinë e personave të vendosur jashtë vendit me dokumente të rregullta dhe në kategorinë e personave që u bënë subjekt i kthimeve të njëpasnjëshme.

Në këtë kontekst është shënuar se, që nga viti 2007 deri në vitin 2009, Shqipëria ka riatdhesuar mesatarisht 65,000 deri në 75,000 emigrantë shqiptarë në vit, nga të cilat rreth 75% janë kthyer nga Greqia. Këto kthime janë bazuar në shkaqe të ndryshme, ku ka dominuar hyrja ilegale dhe qëndrimi i paligjshëm në BE.

E Drejta Migratore e Bashkimit Evropian

Ashtu sikundër është përmendur më sipër, autoritetet shqiptare janë në hapat e para të zbatimit të kësaj baze ligjore, për pasojë nuk është e qarte se sa dhe si do të zbatohet në praktikë. Legjislacioni për emigracionin është zhvilluar shumë vitet e fundit, duke e trajtuar emigracionin në shumë dimensionë. Gjithsesi, ky kuadër ligjor nuk është pa probleme.

- Së pari, shumë dispozita janë të paqarta dhe me shumë me karakter përshkrues se sa detyrimor.
- Së dyti, nuk është e qartë se sa është mundësia reale e strukturave ekzistuese për zbatimin e tij në praktikë.
- Në këtë drejtim, do të ishte me vend realizimi i një studimi monitorues mbi zbatueshmërinë në praktikë të legjislacionit migrator. Kjo do të mundësonte ose ndryshimin e dispozitave që nuk mund të zbatohen në praktikë, ose marrjen e masave energjike për respektimin e tyre.

- Së treti, disa akte ligjore bien në kundërshtim me disa të tjera, për pasojë ka vend për ndryshime dhe përmirësime të mëtejshme të legjislacionit migrator.

Objektivat e politikave migratore

Politikat migratore të Republikës së Shqipërisë përfshijnë politikat imigratore dhe emigratore, të shprehur në normativën migratore të vendit, e cila është në përputhje edhe me politikën dhe normativën migratore të BE-së. Politikat migratore synojnë:

- minimizimin e kostove nga migracioni i parregullt;
- maksimizimin e përfitimeve nga migracioni i rregullt;
- garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të migrantëve;
- luftën kundër migracionit të paligjshëm;
- nxitjen e kthimit vullnetar;
- mbështetjen e lidhjes ndërmjet migrimit dhe zhvillimit të vendit;
- menaxhimin e flukseve imigratore.

Politika migratore shqiptare është e shprehur në Kushtetutë, si kornizë garantuese e të drejtave dhe lirive të të huajve, e rregulluar me anë të legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore, si dhe urdhrave dhe udhëzimeve përkatëse. Legjislacioni shqiptar mbi migracionin përbëhet nga legjislacioni i brendshëm mbi migracionin si dhe kuadri i akteve dy apo shume paleshe të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Ndryshimet në normativat migratore europiane

Ndryshimi i normativës migratore gjatë viteve të fundit në frymën e legjislacionit të BE-së ka synuar ndërtimin e një platforme të re të politikave migratore, për më shumë partneritet në menaxhimin global të migracionit. Kështu kuadri ligjor shqiptar ka shënuar mjaft përmirësime në aspekt të: i) procedurave të dokumenteve të udhëtimit; ii) vizave; iii) punësimit; iv) qëndrimit; v) bashkimit familjar; vi) luftës kundër migracionit të paligjshëm, përfshirë të miturit e pashoqëruar, hyrjen e paligjshme, qëndrimin e paligjshëm, punësimin e paligjshëm, martesat fiktive, përgjegjësitë e transportuesit; vii) politika e kthimit, ripranimeve dhe riintegritit të qëndrueshëm të të kthyerve; viii) politikës së largimeve, dëbimeve, ndalimeve; ix) politikës së mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të migrantëve dhe mbrojtjes së të dhënave personale; x) politikës dhe masave represive dhe ankimit; xi) politikës së integritit të imigrantëve, etj.

Legjislacioni shqiptar parashikon se nxitja e kthimit të emigrantëve dhe ri-integrimi i tyre në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit mund të realizohet me anë të lehtësive fiskale dhe programeve të zhvillimit të biznesit, punësimit dhe formimit profesional. Sidoqoftë nuk është e qartë se si do të realizohen lehtësitë fiskale dhe programet e zhvillimit të biznesit sepse nuk janë hartuar ende aktet nënligjore në këtë drejtim. Në bazë të ligjit, emigrantët e kthyer, të cilët kanë përfutur statusin e migrantit gjithashtu përjashtohen nga pagesat doganore dhe taksat për sendet vetjake dhe pajisjet profesionale, ne përputhje me legjislacionin në fuqi.

Por sikundër përmendet me sipër, akoma nuk është përcaktuar qartë se si do të fitohet ky status. Legjislacioni shqiptar parashikon se ri-integrimi i shtetasve shqiptarë të ri-kthyer duhet të realizohet nëpërmjet programeve trajnuese, regjistrimit në zyrat e punësimit dhe punësimin e tyre me përparësi nga këto zyra, njohjes së kualifikimeve profesionale dhe arsimit, në mënyrë të veçantë për fëmijët me qëllim që të mos bien nga niveli, dhënien e ndihmës financiare për ri-integrim ekonomik, ruajtjen e të drejtave të sigurimeve shoqërore etj.

Efektet e masave aktuale ndaj migracionit.

Që nga riatdhësimet e para të emigrantëve shqiptarë, struktura kryesor qeveritare e ngarkuar me trajtimin e të kthyerve ishte Policia e Shtetit dhe përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit. Për shkak të rrethanave të përgjithshme socio-ekonomike, si dhe në lidhje me fokusin që çdo organizatë e policisë ka, e vetmja çështje që kishte të bënte me Policinë në këtë proces në fillim ishte ajo e personave në kërkim.

Angazhimet e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian, veçanërisht gjatë dhe pas nënshkrimit të MSA-së, si dhe para liberalizimit të vizave, çuan në një rritje të vetëdijes për ri pranim-kthimet, duke u fokusuar edhe në identifikimin e motiveve të migrimit, segmenteve vulnerabël kufitare në lidhje me migrimin ilegal, origjinës dhe rajoneve të qëndrimit të të kthyerve, kategorive më të prekura, etj.

Në qershor të vitit 2010 është hartuar një Strategji Kombëtare për Riintegrimin 2010 - 2015. Kjo strategji ka përfshirë edhe aktorë të tjerë, përveç Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, në procesin e trajtimit të të kthyerve.

Përveç informacionit në media dhe në komunitet në lidhje me kushtet e liberalizimit të vizave, për herë të parë një fushatë informacioni është ndërmarrë edhe në lidhje me të kthyerit dhe sidomos për ata që janë kthyer nga vendet e BE. Gjatë procesit të intervistimit të personave të riatdhesuar, përveç informacionit verbal nga intervistuesit, kishte fletëpalosje informative të dorëzuara, në të cilat përfshiheshin, ndër të tjera, edhe adresat e shërbimeve të punës në çdo qark. Grupet e përbashkëta me inspektorët nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe ministritë e tjera të linjës kanë ndërmarrë aktivitete të komunikimit ndaj qytetarëve dhe monitoruar aktivitetet mbi strukturat lokale vartëse në aspektin e riintegrimin e të kthyerve. Bashkëpunimi në këtë fushë përfshihen të gjithë aktorët e interesuar qeveritare si dhe aktorë nga shoqëria civile. Ka pasur angazhime nga OJQ-të dhe bizneset private, edhe në këtë kontekst. Për trajtimin e kthyerve ka pasur kontrata të ndihmës ushqimore dhe transportit nënshkruar në vendin e tyre të banimit, ku ata mund të kontaktonin në zyrat lokale të integrimit, me qëllim të adresimit në institucionin përkatës.

Fluksi i azilkërkuesve, shtetas shqiptarë në vendet e BE-së

Ndërkohë që fluksi i emigrimit të shqiptarëve në formë të parregullt

është ulur ndjeshëm, fluksi i shtetasve shqiptarëve që kërkojnë azil në vendet e BE-së është rritur gjatë viteve të fundit.

ë figurën e mëposhtme paraqitet dinamika e kërkesave për azil në këto vende gjatë periudhës 2012-2015.

Shtetas shqiptare që kanë kërkuar azil në shtete e BE-së, 2012, 2013,2014, 2015

Viti	Shtetas që kanë kërkuar azil
2012	7,336
2013	11,040
2014	1,222
2015	530,800

Vendet kryesore ku shtetasit shqiptarë kanë kërkuar azil janë Gjermania, Greqia, Suedia, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Belgjika. Arsyet kryesore të azil kërimit kanë qenë ato ekonomike, duke çuar për rrjedhojë në nivele të larta refuzimi lartë të kërkesës për azil nga vendet e BE-së.

Sa i përket kthimit, të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011, tregojnë që rreth 139.827 shqiptarë janë kthyer në Shqipëri në periudhën 2001-2011, kryesisht meshkuj. Të kthyerit janë relativisht të rinj dhe në moshë pune. Në terma numerike, arsyet familjare dhe të punësimit dominojnë mes arsyeve të kthimit; kryesisht papunësia është arsyeja dominuese për meshkujt dhe arsyet familjare janë arsyeja

dominuuese e kthimit të femrave. Ndërsa disa nga këta individë kthehen në Shqipëri për të mos u larguar më, për shumë prej tyre kthimi është i përkohshëm (Maroukis dhe Gemi 2013).

Në këtë kuptim, migracioni i kthimit i kapur në census është një foto çasti e migracionit të vazhdueshëm qarkullues⁵ Sa i përket kthimit, nga vrojtimi rezulton që gjithsej 133.544 migrantë shqiptarë të moshës 18 vjeç dhe sipër janë kthyer në Shqipëri në periudhën 2009-2013, prej të cilëve 98.414 meshkuj dhe 35.130 femra.

Tiparet e tregut të punës dhe flukset migratore

Disa nga tiparet e tregut të punës në Shqipëri, të cilat ndikojnë në inkurajimin e flukseve migratore janë:

- Niveli i lartë i papunësisë rinore:
- Niveli i lartë i papunësisë afatgjatë dhe i dekurajimit jashtë tregut të punës:
- Tregu i punës mbetet refraktar e joelastik edhe ndaj të rinjve që shkollohen:
- Shpërndarja e pabarabartë e papunësisë:
- Papunësia e lartë në fshat e bujqësi:

⁵ INSTAT, 2014

Përgjithësisht Shqipëria mund të konsiderohet si një vend origjine i emigracionit, si vend që është tentuar të jete vend transit i emigracionit të paligjshëm, por dhe si vend destinacioni i imigracionit.

Strategjia për ri-integrimin e të kthyerve:

Duke i kategorizuar kemi:

- emigrantë shqiptarë të cilët kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme;
- kalojnë kufirin e rregullt, por rrinë në vendin e tyre të destinacionit;
- që kalojnë kufirin dhe të qëndrojnë brenda kohëzgjatjes së kufijve të qëndrimit, por punojnë në mënyrë të paligjshme;
- që tentojnë të kalojnë ilegalisht në Britaninë e Madhe ose të cilët kërkojnë azil në Gjermani;
- që punojnë në sezona ose edhe vetëm disa ditë në vendet e BE apo vendet fqinje të Ballkanit;
- janë emigrantë ekonomik.

Pa kaluar nëpër çdo mase të marrë deri më tani, është e qartë se të gjitha masat shtrënguese që merren kundër të kthyerve ose për të parandaluar një parregullsi të mundshme, kanë dështuar dhe jo vetëm nuk kanë arritur objektivin por e kanë përkeqësuar situatën. Masat ndëshkimore kanë dështuar pasi kemi të bëjmë me pjesën më të varfër të shoqërisë e cila vazhdon të ndjehet e pashpresë dhe nuk i ka mbetur asgjë për të humbur duke çuar drejt e në një rreth të mbyllur situatash

të parregullta. Për më tepër, disa nga masat, si refuzimi i daljes, hyrjes dhe gjobat, kanë shtyrë edhe një pjesë të personave të rregullt ndaj parregullsive.

Pavarësisht nga të metat e tyre, masa të tjera informative dhe mbështetëse kanë arritur të kenë - në një masë të caktuar një ndikim pozitiv mbi qytetarët. Një element pozitiv për tu përmendur këtu janë fushatat e informimit për liberalizimin e vizave, gjatë së cilës u vu re ulja e numrit të personave të depërtuar.

Strategjia për Riintegrimin (2010-2015) dështoi dhe nuk dha një zgjidhje reale për problemin e emigrantëve shqiptarë të kthyer, por gjatë kohës që ishte aplikuar kishte të paktën një ndikim në vetëdijen e përgjithshme.

Nëse e shikon jashtë vendit, rezulton se ka praktika të mira edhe në lagje të ngushtë për riintegrimin e të kthyerve. Për shembull, është rasti i Kosovës, ku edhe pse fluksi i emigrantëve të parregullt apo azilkërkuesve ekonomike ende vazhdon, shifrat kanë rënë në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i zbatimit të një strategjie efektive sipas së cilës Qeveria e Kosovës mori përgjegjësi të veçanta në lidhje me riintegrimin. Një tjetër praktikë e mirë është memorandumi midis Shqipërisë dhe Greqisë për shkarkimin e të miturve nga veprat penale të lidhura me kalimin e kufirit, në rastet kur ata kthehen vullnetarisht. Ky akt, i cili ka funksionuar mirë edhe në praktikë, u ka mundësuar të miturve të kthehen në shtëpi pa u frikësuar nga dënimet e mundshme.

Një veprim i ngjashëm është edhe trajtimi i të kthyerve të shtetasve shqiptarë vullnetarisht nga Gjermania, ku personat e kthyer pas kërkesës së tyre për azil nuk është aprovuar, ose për shkak se ata kanë hequr dorë nga kërkitimi i azilit, nuk janë trajtuar si të deportuar dhe nuk dënohen edhe në qoftë se ata kanë kaluar kufirin ilegalisht.

Megjithatë, këto aktivitete nuk do të jetë efektive nëse ato veprojnë ndaras nga njëri-tjetri dhe janë aplikuar vetëm në periudha separatiste. Riintegrimi i të kthyerve është një proces dhe për këtë arsye duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i integruar.

Strategjia “Për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer 2011-2015” është pothuajse i përfunduar dhe puna për strategjinë e ardhshme ka filluar, profili i emigrantëve të paligjshëm dhe të kthyerve, si dhe përvojat më të mira të vendeve me probleme të ngjashme dhe të metat e aktiviteteve aktuale në vendin tonë duhet të merret seriozisht në konsideratë, për të patur një proces të suksesshëm më tej në këtë drejtim.

Strategjia për riintegrimin dhe plani i saj i veprimit duhet të përcaktojë objektiva specifike, të matshme dhe në kohën e duhur. Këto duhet të shoqërohet edhe me hapat dhe rekomandimet specifike dhe të arritshme, për lehtësimin e zbatimit dhe gjithashtu për monitorimin e performancës.

Strategjia e Riintegritimit 2010-2015 thekson se 99% e të kthyerve janë emigrantë ekonomikë, bazuar në të dhënat dhe intervistat e zhvilluara me ta.

Për këtë arsye, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ka për të marrë një rol të rëndësishëm në këtë proces. Nisur nga nevojat e personave të riatdhesuar, aktorë të tjerë të interesuar janë edhe ministritë e tjera të linjës, të zbatimit të ligjit, agjencitë përfaqësues të OJQ-ve dhe të shoqërisë civile.

Për të siguruar ndërhyrjet qëndrueshmërisë dhe efektive, ngritja e një mekanizmi kombëtar referimi, të ngjashme me atë të anti-trafikut, mund të jetë i dobishëm në këtë drejtim, me qëllim për të adresuar problemet në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme.

Është e nevojshme gjithashtu që nëngrupet e kategorisë së emigrantëve ekonomikë të kthyer në shtëpi të përcaktohen me kujdes dhe me saktësi në mënyrë që masat e marra të jenë të qarta dhe të adresuara.

Bibliografi

Deklarata Amerikane për të Drejtat dhe Detyrimet e Njeriut, 1948
[O.A.S. Res. XXX]

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948 [G.A. res. 217A]

E Drejta Migratore Ndërkombëtare

Karta e Kombeve të Bashkuara, 1945 (hyrja në fuqi në 24 tetor 1945)

Karta Sociale Evropiane, 1961 (hyrja në fuqi në 26 shkurt 1965) [529
U.N.T.S. 89]

Konventa (IV) në respektim të ligjeve dhe traditave të luftës në tokë dhe aneksit të saj: Rregulla lidhur me ligjet dhe traditat e luftës në tokë, Hagë, 1907 (hyrja në fuqi në 26 janar 1910) [187 Consol. T.S. 227]

Konventa “Mbi Statusin e Refugjatit”, 1951 (hyrja në fuqi në 22 prill 1954) [189 U.N.T.S.137]

Konventa “Për disa çështje lidhur me konfliktin e ligjeve për shtetësinë”, 1930 (hyrja në fuqi në 1 korrik 1937)

Konventa “Për parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të genocidit”, 1948 (hyrja në fuqi në 12 janar 1951) [78 U.N.T.S. 277]

Konventa “Për privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara”, 1946 (hyrja në fuqi në 17 shtator 1946) [1 U.N.T.S. 15]

Konventa e Montevideos “Për të drejtat dhe detyrimet e shteteve”, 1933 (hyrja në fuqi në 26 dhjetor 1934)

Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës Nr.C29 “Mbi me punën e detyruar”, 1930 (hyrja në fuqi në 1 maj 1932; shfuqizuar nga Konventa Nr.C105, 1957)

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 1950 (hyrja në fuqi në 3 shtator 1953) [213 U.N.T.S. 222]

Konventa IV e Gjenevës “Për me mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte”, 1949 (hyrja në fuqi në 21 tetor 1950) [75 U.N.T.S. 287]

Konventa në lidhje me statusin e personave pa shtetësi, 1954 (hyrja në fuqi në 6 qershor 1960) [360 U.N.T.S. 117]

Konventa shtesë “Për zhdukjen e skllavërisë, tregëtisë së skllëvërve dhe institucioneve dhe praktikave të ngjashme me skllavërinë”, 1956 (hyrja në fuqi në 30 prill 1957) [226 U.N.T.S. 3] 84

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (2008), “Identifikimi i zonave të prekura nga emigracionit dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: Profili i migrantëve të kthyer”. IOM, Tiranë: Shqipëri.

Protokolli IV i Konventës Evropiane të vitit 1950 për të Drejtat e Njeriut, 1963 (hyrja në fuqi në 2 Maj 1968) [E.T.S. Nr. 46]

Rregullore (KE) Nr. 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 Mars 2006, që përcakton një Kod Komunitar mbi rregullat e administrimit të lëvizjes së personave përgjatë kufijve (Kodi i Kufijve Schengen), e ndryshuar, Numri CELEX 2006R0562, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr.105, datë 13.4.2006,

ZGJERIMI I NATO-S: ÇFARË DO TË SJELLË SAMITI I VARSHAVËS?

Wojciech LORENZ,

Mário NICOLINI

Në një kontekst tërësisht të ri sigurie, pas sulmit rus ndaj Ukrainës, NATO po rishikon të gjitha parimet themelore, të cilat kanë udhëhequr vendimet e saj gjatë dy dekadave të fundit. Zgjerimi, politika kryesore e Aleancës për të realizuar vizionin e një Evrope si një të tërë, të lirë dhe në paqe, nuk ka qenë dhe nuk duhet të përbëjë një përjashtim.

Me zgjerimin e parë pas Luftës së Ftohtë në vitin 1999, që përfshiu Poloninë, Republikën Çeke dhe Hungarinë, NATO ka vepruar në bazë të angazhimit të Politikës së Derës së Hapur. Sipas nenit 10 të Traktatit të Uashingtonit, politika e re filloi njëkohësisht me një Politikë të re Partneriteti në vitin 1994. Që atëherë Aleanca ka arritur në 28 anëtarë, duke lënë pas ndarjet e kontinentit evropian në sfera ndikimi sipas Konferencës së Jaltës.

Shpjegimi i Zgjerimit: Zhvillime të rëndësishme

Të gjitha vendet e NATO-s vazhdojnë të mbështesin Politikën e Derës së Hapur. Kjo politikë cilësohet si një proces përmes të cilit a) vendet evropiane që nuk janë anëtare të NATO-s, nëse duan të anëtarësohen, mund t'i afrohen Aleancës dhe mund të fitojnë të drejtën të bëhen

anëtare të klubit, b) me përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit dhe c) pas një vendimi politik nga vendet e NATO-s. Vlera relative e këtyre elementëve ka evoluar me kalimin e kohës.

Ndonëse raundi i parë i zgjerimit pas Luftës së Ftohtë u nxit nga qëllime politike, të gjitha raundet e mëpasshme u bazuan në një qasje më sistematike. Kjo u mishërua në strukturën e detajuar të Planit të Veprimit për Anëtarësim (PVA), që u lancua në samitin e Uashingtonit në vitin 1999 dhe që shënoi anëtarësimin e tre vendeve të para të “Evropës së re”: Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia. PVA-ja, duke mbuluar aspektet politike, ekonomike, të mbrojtjes, të burimeve, të sigurisë dhe ato ligjore, tregoi se rritja e numrit të aplikantëve duhet të përgatitej më mirë për anëtarësim, sidomos në reformimin e sektorit të mbrojtjes dhe përmirësimin e interoperabilitetit, sipas orientimit sistematik të NATO-s. Sipas logjikës teknike të PVA-së, aspekti politik, ndonëse trajtohet, ishte më pak i qartë.

Ndoshta ishte perceptuar si më pak i nevojshëm në një mjedis strategjik më të sigurt, që sugjeron “luftërat e zgjedhura” jashtë zone dhe jo luftëra territoriale për mbijetesë.

Të gjitha raundet e zgjerimit të NATO-s pas Luftës së Ftohtë, ose “ekspansioni” siç preferojnë ta quajnë rusët, u shoqëruan me debate mbi reagimet e mundshme të Rusisë dhe efektet e mundshme të zgjerimit mbi sigurinë evropiane në afatgjatë. NATO u përpoq të kapërcente vështirësitë në bashkëpunim të ngushtë me Rusinë

nëpërmjet një partneriteti të institucionalizuar dhe thelbësor, duke mos vendosur forca të rëndësishme në vendet e reja anëtare dhe duke promovuar një hapësirë të sigurisë bashkëpunuese në Evropë, me Rusinë si pjesë e saj.

Megjithatë, kufizimet e bashkëpunimit midis NATO-s, një aleancë e shteteve demokratike të gatshme për të mbështetur dhe mbrojtur vlerat e përbashkëta, dhe Rusisë, e cila i percepton këto vlera si një kërcënim ndaj interesave të saj të sigurisë, kanë dalë zbuluar që në vitin 1999, kur NATO-ja, duke vepruar mbi bazën e arsyeve morale por pa miratimin e OKB-së, nisi operacionin e saj të parë jashtë zonës në Ballkan kundër Serbisë, një aleat i Rusisë. Më pak se një dekadë më vonë, në vitin 2008, lufta Ruso-Gjeorgjiane shërbeu si një shenjë paralajmëruese se Rusia ishte e gatshme të përdorte forcën për të mbështetur konfliktet e ngrira, të kërcënonte integritetin territorial të fqinjëve dhe të parandalonte zgjerimin e mundshëm të NATO-s.

